



Republika e Kosovës Republika Kosova -
Republic of Kosovo Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Ferizajt- Opstina Urosevac- Municipality of
Ferizaj



DRAFT - STRATEGJIA
PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË NË KOMUNËN E FERIZAJT
2024-2029



Ferizaj, Maj 2024

KOMUNA FERIZAJ

Dokumenti “Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2027” është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, bazuar në vendimin me numrin e protokollit: / të datës __/____.

Dokumenti “Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029” është pjesë e projektit “Angazhimi i të Rinjve, një Zë për Ndikim”, i financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së përmes programit “Alumni Engagement Innovation Fund 2023”, mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, administruar nga KUSA dhe zbatuar nga dy anëtarë të Alumni, në bashkëpunim me Organizatën “Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë AdVOICE”.

Ky dokument është përgatitur në përputhje me vendimin Nr. 61/24 të datës 21.03.2024 të Kryetarit të Komunës së Ferizaj, z. Agim Aliu. Një grup pune është formuar për këtë qëllim, i përbërë nga të rinj të zgjedhur nga organizatat joqeveritare, shkollat e mesme dhe përfaqësues të institucioneve.

Përmbajtja

Lista e Akronimeve3

Fjala e Kryetarit të Komunës4

1. Hyrje5
2. Baza ligjore6
3. Metodologjia7
4. Qëllimi i strategjisë8
5. Sfidat aktuale të të rinjve të Ferizajt10
6. Vlerësimi i nevojave15
7. Vizioni15
8. Objektivat16
9. Monitorimi dhe vlerësimi21
10. Miratimi dhe zbatimi22
11. Komunikimi dhe angazhimi i vazhdueshëm22

LISTA E AKRONIMEVE

KF	Komuna e Ferizajt
KKF	Kuvendi i Komunës së Ferizajt
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
KAKRS	Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
KVRL	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
SShR	Strategjia Shtetërore për Rininë
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi

Fjala e Kryetarit të Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu

Të dashur bashkëqytetarë!

Të dashur të rinj ferizajas!

Rinia është pasuria e gjithë shoqërisë!

Rinia është e ardhmja e shtetit dhe e kombit tonë!

Qeverisja jonë, në gjithë historinë politike të Ferizajt, ka moshën mesatare më të re. Ne, kemi hapëruar me të rinjtë, me idenë, me frymëzimin që sjell energjia rinore, duke bartur vetë të rinjtë, përgjegjësi të larta shtetërore. Ky dokument, Strategjia e Rinisë për Komunën e Ferizajt, është themel mbi të cilën zënë fill planet tona të së ardhmes për të rinjtë, është rezultat i punës së të rinjve për t'i vendosur kornizat e ecjes përpara, mbështetjes dhe orientimit të të rinjve ferizajas për vitet pasuese.

Strategjia e Rinisë për Komunën e Ferizajt, vjen si domosdo e kohës, për të orientuar me saktësi, të shtrirë në kohë, e me objektiva të qarta, vizionin tonë për të rinjtë.

Komuna e Ferizajt është institucioni më i lartë në hierarkinë institucionale lokale. Në mesin e punonjësve të administratës komunale janë të shumtë punonjësit me moshën e re, me përgatitjet superiore për t'i shërbyer qytetit dhe qytetarëve, andaj kjo dëshmi flet qartë e zëshëm për fokusin që ka qeverisja jonë për të rinjtë, për besimin e palëkundur në kapacitetet e të rinjve. Gjykuar nga kjo, edhe ky dokument, është natyrshëm produkt i kësaj qasje, këtij motivi, për të aspiruar bashkërisht përpara.

Qasja jonë e zbatuar deri më tani, ishte e mbetet qasje mbështetëse për të rinjtë, në nismat e tyre komunitare, në projektet zhvillimore, në planet e vizionin e të bërit biznes nga të rinjtë, andaj jemi të vendosur, ta shumëfishojmë me gjithë kapacitetet tona këtë mbështetje që rezulton me mundësi më të mëdha për të rinjtë ferizajas.

Dua të shpreh falënderimin tim më të sinqertë, për të gjithë të rinjtë, ekipet punonjëse dhe të gjithë kontributorët në këtë dokument, ashtu që të paraqitet vizioni ynë i qartë dhe politikat tona të mirëfillta rinore për Ferizajn e të rinjve për vitet pasuese.

Ju faleminderit!

1. HYRJE

Ferizaj është një qytet relativisht i ri; megjithatë, zonat përreth tij kanë qenë të banuara prej 6 000 deri në 8 000 vjet më parë. Gjetjet arkeologjike në Varosh, 3 km në jug të Ferizajt, dëshmojnë se këto zona banoreshin që nga periudha e hershme neolitike.

Ferizaj shërben si qendër komunale dhe rajonale në pjesën jugore të Fushës së Kosovës. Gjeografikisht ndodhet në gjerësinë veriore 42°22'80" dhe gjatësinë lindore 21°09'12", në një lartësi mesatare prej 850 metrash mbi nivelin e detit. Qyteti është një kryqëzim i rëndësishëm që e lidh atë me Prishtinën në veri dhe më tej me Evropën Qendrore, me Shkupin në jug drejt Greqisë, me Prizrenin dhe Pejë në perëndim drejt Shqipërisë, Malit të Zi dhe vendeve të Adriatikut, si dhe me Gjilanin në lindje drejt Ballkanit Lindor dhe Lindjes së Afërt.

Distancat nga Ferizaj deri në Prishtinë, Shkup, Gjilan dhe Prizren janë përkatësisht 38 km, 48 km, 32 km dhe 70 km. Ferizaj lidhet me të gjitha këto qytete me rrugë magjistrale dhe me Shkupin, Prishtinën dhe Prizrenin me autostradë. Përveç kësaj, Ferizaj ndodhet 40 km nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

Ferizaj është një qendër rajonale që përfshin komunitet e afërta: Shtime, Shtërpçë, Kaçanik dhe Hani i Elezit. Atraksionet turistike të rëndësishme pranë Ferizajt përfshijnë Brezovicën, e cila po shndërrohet në një qendër ndërkombëtare për skijim dhe turizëm malor dhe është 40 km në jugperëndim të qytetit; Shpella e Gadimes, një monument unik prej mermeri që ndodhet 20 km në veri të Ferizajt; Banja e Kllokotit, e njohur në Ballkan për rehabilitimin shëndetësor dhe kurimin e sëmundjeve reumatike, e cila ndodhet 20 km në lindje; dhe Bifurkacioni i Nerodimes, një fenomen i rrallë hidrografik që ndodhet vetëm 1 km në perëndim të Ferizajt.

Hekurudha e lidh Ferizajn me Shkupin në drejtim të jugut dhe të lindjes, ndërsa me Prishtinën dhe Mitrovicën në drejtim të veriut, duke lehtësuar lidhjet me vendet evropiane.

Gjatë viteve, Ferizaj është identifikuar për rininë e tij aktive dhe të suksesshme. Për pasojë, strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt do të hartohet për të kontribuar më tej në këta komponentë, duke i mbajtur të rinjtë në qendër.

Kjo strategji do të përfshijë një gamë të gjerë veprimesh që synojnë të adresojnë nevojat dhe potencialet e të rinjve në aspekte të ndryshme të jetës së tyre. Këto përfshijnë arsimin, punësimin, pjesëmarrjen në vendimmarrje, shëndetin, kulturën dhe sportin, si dhe përfshirjen në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të të rinjve të komunës së Ferizajt.

Strategjia është një dokument planifikimi dhe orientimi që synon të adresojë nevojat, sfidat dhe mundësitë që hasin të rinjtë në komunën e Ferizajt. Ajo përcakton një qasje të qartë dhe të koordinuar për të mbështetur zhvillimin e tyre në aspekte të ndryshme të jetës. Një strategji

efektive për rininë e Ferizajt është kritike për të siguruar që të rinjtë, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullsisë, të jenë të angazhuar, të fuqizuar dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës sonë.

Disa aspekte kyçe që do të përfshihen në strategji janë:

- Zhvillimi i edukimit joformal dhe aftësive,
- Zhvillimi i komponentës së vullnetarizmit,
- Teknologjia, inovacioni dhe ndërmarrësia rinore,
- Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje dhe politika lokale,
- Mirëqenia, shëndeti mendor dhe siguria e të rinjve,
- Kultura, arti, sporti dhe aktiviteti fizik,
- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i ekonomisë së gjelbërt,
- Mbështetja për komunitetet jo shumicë,
- Mbështetja për të rinjtë me aftësi të kufizuara,
- Mbështetja për të rinjtë e grupeve të tjera të marginalizuara.
- **Rinia, Paqja dhe Siguria (YPS) si dhe Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS)**

Ky dokument strategjik do të jetë në harmoni të plotë me Strategjinë Shtetërore për Rini 2024-2032.

Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032 është një zotim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'u garantuar të rinjve kosovarë një platformë për realizimin e të drejtave dhe potencialeve të tyre.

Përmes masave politike dhe veprimeve të planifikuara, kjo strategji synon t'u ofrojë të rinjve mundësi dhe përvoja që i mbështesin në integrimin e tyre në shoqëri dhe në fuqizimin e tyre si agentë të zhvillimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Me termin 'të rinj', kjo Strategji, sikur edhe Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032, nënkupton të gjithë personat e moshës 15 deri në 29 vjeç, që paraqet grupmoshën që targetohet nga kjo Strategji. Ky term parashihet edhe në draft Ligjin për Rini dhe është në përputhje me përkufizimin e të rinjve të përdorur në Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027.

2. BAZA LIGJORE

Për hartimin e strategjisë për fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve të komunës së Ferizajt, kemi konsultuar bazat ligjore specifike të legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe të komunës së Ferizajt. Kemi mbledhur informacion mbi legjislacionin aktual që lidhet me të rinjtë dhe dokumentacionin e nevojshëm për hartimin e një strategjie të tillë.

Dokumentet që kemi përdorur si bazë ligjore përfshijnë:

- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën E Përgjithshme Administrative
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve Të Veprimit
- Manual Për Planifikimin, Hartimin Dhe Monitorimin E Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit
- Strategjia Shtetërore për Rini 2024-2032 (mkrs-ks.org)
- Statuti i Komunës Së Ferizajt

Si grup punues, kemi kërkuar që Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë të ketë bazën ligjore të nevojshme për t'u përdorur gjatë gjithë procesit të hartimit të saj. Për këtë qëllim, kemi konsultuar edhe Zyrtarët Ligjorë të komunës së Ferizajt për të siguruar që dokumentacioni i marrë për bazë është relevant dhe i përshtatshëm për punën e grupit punues dhe për procesin e hartimit të Strategjisë deri në aprovimin e saj.

Në përgjithësi, për hartimin e strategjisë për fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve në Ferizaj, ka qenë e rëndësishme të konsultohemi me legjislacionin ekzistues që mbulon fushën e rinisë dhe çështjet e tjera që lidhen me aspektin administrativ.

3. METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të Strategjisë ka përfshirë fazat e formimit të ekipit drejtues, analizës së situatës aktuale, përfshirjes dhe konsultimit me palët e interesit, përcaktimit të qëllimeve dhe prioritetëve strategjike, zhvillimit të planit, mekanizmave të zbatimit dhe koordinimit, monitorimit dhe vlerësimit, si dhe komunikimit dhe angazhimit të vazhdueshëm.

Formimi i ekipit drejtues, sipas vendimit Nr. 61/24 të datës 21.03.2024 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, ka përfshirë përfaqësues nga institucionet lokale, organizatat rinore, sektori privat dhe ekspertë të fushave përkatëse për të drejtuar procesin dhe për të siguruar pjesëmarrjen dhe konsultimin e gjerë.

Analiza e situatës dhe identifikimi i nevojave është realizuar përmes takimeve me grupe të ndryshme të interesit për të adresuar sfidat dhe nevojat aktuale të rinisë në Ferizaj.

Përfshirja dhe konsultimi me palët e interesit është bërë duke identifikuar dhe përfshirë organizata joqeveritare, komunitetet lokale dhe grupet e interesit për të siguruar që perspektivat dhe nevojat e të gjitha palëve janë të përfaqësuara në mënyrë efektive.

Përcaktimi i qëllimeve dhe prioriteteve strategjike është bërë duke u bazuar në analizën e nevojave dhe aspiratave të të rinjve dhe duke synuar të ofrojë zgjidhje efektive dhe të qëndrueshme për ta.

Zhvillimi i planit të hartimit të strategjisë ka përfshirë përcaktimin e objektivave specifike, veprimeve të detajuara, përcaktimin e përgjegjësisë dhe afateve kohore për të siguruar zbatimin e saj.

Mekanizmat e zbatimit dhe koordinimit do të sigurojnë që të gjitha institucionet e përfshira të jenë përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe që burimet financiare të përdoren në mënyrë efektive dhe transparente.

Monitorimi dhe vlerësimi do të jenë të rregullt dhe objektive për të siguruar progresin dhe për të identifikuar sfidat për përmirësim të strategjisë për rininë në Ferizaj.

Miratimi dhe zbatimi i strategjisë do të bëhen duke u bazuar në dokumentin final të hartuar dhe duke siguruar pjesëmarrjen e gjerë të palëve të interesit për të garantuar arritjen e qëllimeve të strategjisë.

Komunikimi dhe angazhimi i vazhdueshëm do të jenë thelbësorë për të mbajtur të rinjtë dhe palët e interesit të informuar dhe të përfshirë në zbatimin e strategjisë për rininë në komunën e Ferizajt.

4. QËLLIMI I STRATEGJISË

Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të ndihmojë në fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve të komunës së Ferizajt. Ky dokument synon të ofrojë mundësi trajnimi dhe zhvillimi personal për të rinjtë, duke rritur aftësitë e tyre për të qenë qytetarë aktivë dhe produktivë në shoqëri.

Në këtë kontekst, disa qëllime specifike të strategjisë që i kemi përfshirë janë:

1. **Teknologjia, inovacioni dhe ndërmarrësia rinore:** Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme.
2. **Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje dhe në politikat lokale:** Përfundim i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale.
3. **Përqindja minimale e pjesëmarrjes së të rinjve në komisionet komunale,**
4. **Numri i konsultimeve publike me rininë,**
5. **Mirëqenia, shëndeti mendor dhe siguria e të rinjve:** Promovimi i një stili jetese të shëndetshëm dhe ofrimi i shërbimeve për mirëqenien e të rinjve.
6. **Barazia dhe gjithëpërfshirja:** Sigurimi i barazisë dhe pjesëmarrjes së të gjithë të rinjve në jetën sociale dhe politike të komunitetit. Këtu rekomandohet mbështetja për komunitetet

jo shumicë, mbështetja për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe mbështetja për të rinjtë e grupeve të tjera të marginalizuara.

7. **Zhvillimi i komponentës së vullnetarizmit:** Inkurajimi i të rinjve për t'u angazhuar në punë vullnetare dhe për të kontribuar në mirëqenien e komunitetit.
8. **Kultura, arti, sporti dhe aktiviteti fizik:** Inkurajimi i të rinjve për t'u angazhuar në aktivitete fizike dhe sportive, si dhe në art, kulturë dhe trashëgimi kulturore.
9. **Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i ekonomisë së gjelbërt:** Mbështetja e nismave që promovojnë ekonominë e gjelbërt dhe mjedise të pastra e të gjelbërta.

Në të gjitha këto fusha synohet që të rinjtë të kenë një rol aktiv dhe të ndikojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit të tyre. Për këtë arsye, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse dhe ofrimi i mundësive për zhvillim personal dhe profesional janë gjithnjë thelbësore. Një fokus i veçantë i kushtohet përfshirjes të të rinjve me aftësi të kufizuara për të siguruar një pjesëmarrje të barabartë me të tjerët në jetën shoqërore dhe politike të komunitetit. Secili qëllim specifik do të ketë vëmendje të veçantë.

5. SFIDAT AKTUALE TË TË RINJVE TË FERIZAJT

Të rinjtë e Ferizajt, siç është rasti edhe në shumë komuna të tjera në Kosovë, përballen me sfida të ndryshme që ndikojnë në zhvillimin e tyre personal, profesional dhe social. Këto sfida, ndonëse të ndryshme në natyrë, shpesh kanë rrënjë të përbashkëta me ato që hasen në shumë vende të tjera, duke përfshirë mungesën e mundësive për punësim në profesione sipas përgatitjes profesionale, çështjet e shëndetit mendor, mungesën e gjithpërfshirjes, mungesën e aktivitetit rekreativ-sportiv, sfidat e integritetit social dhe politik, si dhe ndikimin e përdorimit të tepërt të teknologjisë.

Është kryer një analizë më e detajuar e disa prej këtyre sfidave për të identifikuar hapat konkretë që mund të ndërmerren për të përmirësuar kushtet dhe mundësitë për të rinjtë në këto fusha. Ky qëndrim analitik ndihmon në hartimin e strategjive që synojnë të adresojnë në mënyrë efektive këto pengesa, duke u mundësuar të rinjve të Ferizajt të arrijnë një zhvillim të plotë dhe të balancuar.

5.1. Mungesa e mundësive për punësim sipas përgatitjes profesionale

Një nga sfidat më të mëdha për të rinjtë në Ferizaj është mungesa e mundësive të punësimit sipas profileve apo përgatitjes profesionale. Pavarësisht nga përpjekjet për të përmirësuar situatën ekonomike, shkalla e lartë e papunësisë sipas profesioneve mbetet një problem kryesor. Të rinjtë shpesh përballen me një treg pune të ngushtë, ku mundësitë për punësim janë të kufizuara dhe konkurrenca është e lartë. Kjo i detyron ata të bëjnë punë të tjera që nuk janë në sinkroni me përgatitjen e tyre, duke i shtyrë shumë prej tyre të kërkojnë mundësi jashtë vendit ose të angazhohen në punë që nuk i përmbushin aspiratat e tyre profesionale.

Megjithatë, sipas Agjencisë së Punësimit në Ferizaj, sa i përket Strategjisë për Zhvillim dhe Fuqizimin e Rinisë në fushën e Punësimit, Zyra e Punësimit në Ferizaj, përmes Agjencionit të Punësimit të Republikës së Kosovës dhe me fonde të BE-së, këtë vit (2024) ka filluar me pilotimin e programit për Garancinë Rinore - Youth Guarantee për 3 vjet (2024 - 2026) pikërisht për grupmoshën 15 - 29 vjet. Për të realizuar këtë program, përveç trajnimeve dhe certifikimeve që ofrohen në QAP, si dhe operatorët e ndryshëm që janë të akredituar në Ministrinë e Arsimit në profesionet e ndryshme për të përgatitur të rinjtë për tregun e punës, ofrohen edhe disa nga skemat nxitëse të punësimit siç janë:

- Praktika në punë me pagesë
- Trajnimi në punë me pagesë
- Subvencionimi në pagë
- Grante për vetëpunësim

Këto masa synojnë të ndihmojnë të rinjtë të integrohen më efektivisht në tregun e punës dhe të përmbushin aspiratat e tyre profesionale, duke kontribuar në njëkohësisht në zhvillimin ekonomik të komunitetit.

5.2. Çështjet e shëndetit mendor dhe të mirëqenies

Shëndeti mendor i të rinjve është një çështje shumë e rëndësishme dhe komplekse, pasi ata ndodhen në një fazë të jetës së tyre që është e ndryshme ndaj ndryshimeve të shumta dhe sfidave të jetës. Disa çështje kyçe që ndikojnë në shëndetin mendor të të rinjve janë:

- **Stresi dhe presioni:** Të rinjtë përballen me stresin nga shkolla, familja, shoqëria dhe shumë të tjerë. Presioni për të performuar mirë në shkollë, për të gjetur një karrierë të suksesshme dhe për të përballuar ndryshimet fizike dhe emocionale të adoleshencës mund të shkaktojnë stres dhe ankth.
- **Ndikimi i medias dhe rrjeteve sociale:** Mediat sociale luajnë një rol të madh në formimin e perceptimeve dhe emocioneve të të rinjve, duke ndikuar ndjeshëm në shëndetin e tyre mendor.
- **Problemet familjare:** Konfliktet në familje, si dhe ndarjet e prindërve, janë burim stresi dhe ankthi për të rinjtë. Një mjedis familjar mbështetës dhe pozitiv është esencial për mirëqenien e tyre mendore.
- **Depresioni dhe ankthi:** Këto janë dy nga problematikat më të shpeshta të shëndetit mendor në mesin e të rinjve, të cilat mund të rrjedhin nga situatat stresuese, por mund të lidhen gjithashtu edhe me faktorë biologjikë dhe gjenetikë.
- **Ndikimi i mjedisit shkollor:** Mjedisi në shkolla ka një ndikim të konsiderueshëm në shëndetin mendor të të rinjve. Mungesa e përfshirjes, problemet me bullizmin, ose

stigmatizimi rreth çështjeve si orientimi seksual ose identiteti gjinor mund të shkaktojnë probleme serioze të shëndetit mendor.

Për të përmirësuar shëndetin mendor të të rinjve është jetike të sigurohen mundësi dhe mbështetje për menaxhimin e stresit, të promovohet gjithpërfshirja dhe të krijohet një ambient i sigurt dhe mbështetës jo vetëm në familje, por edhe në shkolla dhe në mjedise të tjera sociale. Gjithashtu, është thelbësore të ofrohet qasje prioritare në shërbimet shëndetësore dhe mendore për ata që kanë nevojë.

5.3. Mungesa e gjithpërfshirjes te të rinjtë

Mungesa e ndjenjës së gjithpërfshirjes te të rinjtë përbën një sfidë të madhe për shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore dhe emocionale. Kur individët ndihen të izoluar ose të përjashtuar nga grupet sociale, ata mund të përjetojnë ndjenja të thella vetmie, ankthi dhe depresioni. Disa nga faktorët që kontribuojnë në këtë ndjesi të mungesës së gjithpërfshirjes janë:

- **Bullizmi:** Në mjedise si shkollat dhe të tjera kontekste sociale, bullizmi, mund të çojë në izolim dhe përjashtim të të rinjve. Kjo ndikon negativisht në vetëvlerësimin e tyre dhe në aftësinë për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët.
- **Ndjenjat e pakënaqësisë me veten:** Në disa raste, moskënaqësia me veten mund të bëjë që të rinjtë të ndihen të distancuar nga të tjerët. Pasiguria në marrëdhëniet personale dhe ndjesia e mospërshtatshmërisë mund të çojnë në ndarje sociale.
- **Ndikimi i mediave dhe i rrjeteve sociale:** Imazhet e bukurisë së papërballueshme dhe perfeksionit të paraqitur në rrjete sociale mund të nxisin ndjenja të pakënaqësisë me veten te të rinjtë, duke i shtyrë ata, të ndihen të përjashtuar nga standardet e larta të shoqërisë.
- **Problemët familjare:** Rritja në një mjedis familjar të mbushur me konflikte ose mungesa e mbështetjes dhe kujdesit të duhur mund të çojnë drejt shfaqjes së ndjenjës së vetmisë dhe izolimit.

Për të trajtuar këto sfida dhe për të promovuar ndjenjën e gjithpërfshirjes te të rinjtë, veçanërisht duke përfshirë komunitetet jo shumicë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera të marginalizuara, është thelbësore të ndërtojmë mjedise ku ata ndihen të pranuar dhe të mbështetur. Kjo kërkon ngritjen e ndërgjegjësimit rreth pasojave të bullizmit, zbatimin e programeve të përkrahjes emocionale në shkolla dhe komunitete dhe promovimin e një kulture të tolerancës dhe të respektit ndaj të gjitha formave të diversitetit dhe identitetit.

5.4. Mungesa e aktiviteteve rekreative dhe sportive

Mungesa e aktivitetit rekreativ-sportiv në jetën e të rinjve përbën një çështje serioze për shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Në një epokë ku teknologjia dominon përditshmërinë, shumë të rinj gjejnë

më pak interes për pjesëmarrjen në aktivitete të jashtme dhe sportive. Kjo mungesë aktiviteti mund t'u atribuohet disa faktorëve kyç:

- **Teknologjia dhe video-lojërat:** Intensiteti i përdorimit të pajisjeve elektronike dhe video-lojërave ka zëvendësuar kohën që mund të ishte dedikuar për ushtrime fizike dhe sportive.
- **Mungesa e kohës së lirë:** Oraret e ngjeshura me angazhime akademike, profesionale dhe detyra të tjera të përditëshmërisë, lënë pak hapësirë për aktivitete rekreative jashtë rutinës së zakonshme.
- **Mungesa e motivimit:** Në një numër të rinjsh mund të mungojë motivimi për angazhim në aktivitete fizike, qoftë si pasojë e mungesës së interesit, stresit ose një ndjenje të përgjithshme të pasigurisë dhe demoralizimit.
- **Mungesa e burimeve financiare dhe infrastrukturës:** Në disa raste, mungesa e një infrastrukture sportive të përshtatshme ose nevoja për përdorimin e hapësirave sportive me pagesë mund të limitojë mundësitë e të rinjve për të qenë aktivë fizikisht.

Për të trajtuar këtë problem, është esenciale të ndërtojmë dhe të promovojmë mjedise që inkurajojnë aktivitetin fizik në mesin e të rinjve. Kjo mund të realizohet përmes:

- **Ofrimit të programeve sportive dhe rekreative në shkolla dhe komunitete:** Krijimi i mundësive të qasshme dhe tërheqëse për të gjithë të rinjtë.
- **Përmirësimi i infrastrukturës sportive:** Investimi në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave sportive që janë lehtë të aksesueshme për të gjithë.
- **Edukimi mbi përfitimet shëndetësore:** Rritja e ndërgjegjësimit rreth avantazheve që aktiviteti fizik ofron për shëndetin fizik dhe mendor, duke përfshirë reduktimin e stresit dhe përmirësimin e humorit.
- **Nxitja e motivimit:** Prezantimi i aktiviteteve që janë argëtuese dhe që zgjojnë interesin e të rinjve, duke krijuar një kulturë të shëndetshme dhe të gjallë rekreative.

Nga një perspektivë më e gjërë, këto hapa, jo vetëm që do të ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor të të rinjve, por do të kontribuojnë edhe në formimin e një shoqërie më të gjallë dhe të përfshirë.

5.5. Sfidat e integritit social dhe politik

Të rinjtë në Ferizaj, ashtu si në shumë pjesë të tjera të Kosovës, kanë hasur vazhdimisht në sfidën e integritit social dhe politik. Angazhimi i tyre në proceset vendimmarrëse, jo vetëm në nivel lokal, por edhe kombëtar, është thelbësor për të ndërtuar një shoqëri të përfshirë dhe demokratike.

Sidoqoftë, deri më sot, mungesa e platformave adekuate që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve ka rezultuar në një përjashtim të tyre nga diskutimet dhe vendimet që i prekin drejtpërdrejt.

Edhe pse kjo gjendje ka pësuar përmirësime të dukshme në vitet e fundit, ende ka hapësirë të madhe për përmirësim.

Për të përballuar këtë sfidë dhe për të nxitur përfshirjen e të rinjve në jetën politike dhe sociale, është e rëndësishme:

- **Të rritet ndërgjegjësimi dhe të ofrohen trajnime për të rinjtë:** Zhvillimi i programeve edukative dhe trajnuese që i mësojnë të rinjtë për të drejtat, përgjegjësitë dhe proceset vendimmarrëse mund të nxisë përfshirjen e tyre.
- **Të krijohen platforma të reja dhe të përmirësohen ato ekzistuese:** Platformat që lejojnë dhe nxisin dialogun dhe përfshirjen aktive të të rinjve në politikë duhet të zgjerohen dhe të bëhen më të aksesueshme.
- **Të ndërtohen ura ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve:** Inkurajimi i takimeve dhe diskutimeve mes të rinjve dhe politikanëve mund të ulë distancën dhe të rrisë ndikimin e tyre në vendimet që i prekin.

Përmirësimi i këtyre aspekteve do të kontribuojë në një shoqëri më dinamike dhe të përfshirë, ku zëri i të rinjve jo vetëm dëgjohej, por edhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e politikave dhe praktikave vendore dhe kombëtare.

5.6. Ndikimi i përdorimit të tepërt të teknologjisë

Teknologjia dhe rrjetet sociale, si kudo tjetër, ushtrojnë një ndikim të dyfishtë në jetën e të rinjve edhe në Ferizaj. Nga njëra anë, ato ofrojnë platforma për mësim, kreativitet dhe lidhje sociale, duke hapur kështu mundësi të reja që nuk ishin të disponueshme më parë. Nga ana tjetër, përdorimi i tepruar dhe pa kriter i këtyre mjeteve mund të shkaktojë izolim social, varësi dhe ndikime negative në shëndetin mendor, çka e bën sfiduese për të rinjtë dhe prindërit e tyre të menaxhojnë këto efekte.

Në Kosovë, përdorimi i internetit për aktivitete sociale është dukshëm më i lartë se ai për qëllime edukative apo profesionale, me vetëm 50% të të rinjve që e përdorin atë për të mësuar ose punuar. Kjo tregon një mungesë të qartë të orientimit të teknologjisë për të mbështetur zhvillimin personal dhe profesional të të rinjve.

Sfidat me të cilat përballen të rinjtë e Ferizajt kërkojnë një përgjigje të koordinuar nga qeveria, sektori privat, organizatat joqeveritare dhe komuniteti në përgjithësi. Është thelbësore që të merren masa për të adresuar këto sfida, në mënyrë që të rinjtë të kenë mundësi të zhvillohen në të gjitha dimensionet e jetës së tyre. Përfundimisht, sfidat aktuale të të rinjve në komunën e Ferizajt pasqyrojnë një sërë problematikash të gjera që pengojnë zhvillimin e tyre të plotë dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon një angazhim aktiv nga qeveria lokale, bashkësia dhe sektori civil për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e të rinjve dhe për të ndërtuar një mjedis më të favorshëm për të ardhmen e tyre.

6. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Vlerësimi i nevojave për strategjinë synon të përcaktojë dhe përshkruajë nevojat e të rinjve në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse, duke u fokusuar te sfidat, mundësitë dhe prioritetet e tyre. Ky proces është jetik për zhvillimin e një strategjie të suksesshme dhe efektive për rininë.

Nevojat kryesore që janë identifikuar nga të rinjtë e Ferizajt përfshijnë:

1. Mbështetje për punësim në fushat përkatëse të tyre profesionale, duke siguruar përputhje midis arsimit dhe tregut të punës.
2. Promovimi i shëndetit mendor përmes iniciativave të edukimit dhe ndërgjegjësimit shëndetësor.
3. Nxitja e barazisë dhe e gjithëpërfshirjes si vlera thelbësore shoqërore.
4. Promovimi i sportit dhe i aktivitetit fizik si pjesë e një stili të shëndetshëm të jetesës.
5. Mbështetje për integrimin social dhe politik të të rinjve, duke i përfshirë ata në proceset vendimmarrëse.
6. Edukimi i të rinjve mbi përdorimin e duhur dhe të sigurt të teknologjisë.
7. Organizimi i fushatave vetëdijësuese kundër sjelljeve devijante si dhuna, droga, duhani, alkooli, etj. dhe promovimi i një jetese të shëndetshme.
8. Ofrimi i mundësive për punë praktike dhe vullnetare në institucionet komunale, organizatat dhe kompanitë private.
9. Fuqizimi i të rinjve nga zonat rurale me qasje në arsim dhe mundësi të barabarta.
10. Ofrimi i mundësive për edukim joformal, duke rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e programeve.
11. Sigurimi i hapësirave rinore që mund të përdoren pa pagesë për aktivitete të ndryshme.
12. Qasje të lehtë, të përshtatshme dhe falas në infrastrukturën sportive dhe kulturore të komunës për të rinjtë.
13. Qasje në dokumentacionin publik dhe zyrtar dhe ngritje të llogaridhënies së institucioneve lokale.
14. Zgjerimi i mundësive për programe të shkëmbimeve të përvojave, edukimit dhe praktikave të mira në nivel nacional dhe regjional.

Këto prioritetet ofrojnë një bazë të fortë për hartimin dhe zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse që adreson nevojat e të rinjve dhe kontribuon në zhvillimin e tyre të plotë dhe të qëndrueshëm.

7. VIZIONI

Komuna e Ferizajt është e përkushtuar në krijimin e një ambienti të favorshëm që mundëson të rinjtë të realizojnë plotësisht potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë. Vizioni është të ndërtohet një kulturë e gjithëpërfshirjes, ku të rinjtë janë aktorë kyç në proceset zhvillimore, të aftë për të sjellë inovacione dhe ide të reja që do të ndihmojnë në përparimin e komunës dhe të shoqërisë në tërësi. Kjo përfshirje, jo vetëm që stimulon zhvillimin ekonomik dhe social, por gjithashtu rrit angazhimin civil dhe ndjenjën e përkatësisë te të rinjtë.

8. OBJEKTIVAT

Objektivat e strategjisë janë ato qëllime specifike dhe të qarta që synohen për t'u arritur përmes implementimit të saj. Këta objektiva janë zhvilluar për të adresuar nevojat e identifikuara të të rinjve dhe për të ndihmuar në arritjen e vizionit dhe misionit të përgjithshëm të strategjisë.

Një objektiv strategjik për komunën e Ferizajt është sigurimi i një ambienti të përshtatshëm dhe mbështetës që promovon zhvillimin e të rinjve në të gjitha aspektet e jetës së tyre. Ky objektiv përfshin përmirësimin e mundësive të punësimit që përputhen me aftësitë dhe përgatitjet e tyre profesionale, pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete kulturore, sportive dhe sociale, si dhe nxitjen e një kulture të fuqishme që inkurajon përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore të komunës.

Kështu, objektivat specifikë të strategjisë synojnë të:

- Përmirësojnë cilësinë dhe përputhshmërinë e punësimit për të rinjtë në Ferizaj.
- Rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në jetën kulturore, sportive dhe sociale të komunitetit.
- Fuqizojnë angazhimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse, duke i bërë ata pjesëmarrës aktivë në zhvillimin e politikave lokale që i prekin direkt.
- Ndërtojnë dhe mbështesin një kulturë të gjithëpërfshirjes, ku të rinjtë ndihen të vlerësuar dhe janë të motivuar për të kontribuar në shoqërinë e tyre.

Përmes këtyre objektivave, komuna e Ferizajt angazhohet të krijojë një mjedis që jo vetëm mbështet rritjen personale dhe profesionale të të rinjve, por gjithashtu e bën komunitetin më dinamik, të bashkuar dhe të përgatitur për sfidat e ardhshme.

Objektivi specifik 1: Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre profesional në fusha të ndryshme.

Aktivitetet e parapara për realizimin e këtij objektivi janë si më poshtë:

- 1.1. **Krijimi i programeve të trajnimit dhe të edukimit:** Hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit dhe edukimit që ofrojnë aftësi praktike dhe njohuri thelbësore në fusha të

ndryshme profesionale. Këto programe do të përfshijnë sesione trajnimi të përqendruara në zhvillimin e aftësive të domosdoshme për tregun e punës sot.

- 1.2. **Ofrimi i mundësive të praktikës dhe të punësimit:** Identifikimi dhe krijimi i mundësive për praktika dhe punësim për të rinjtë në institucione, kompani dhe organizata të ndryshme. Ky aktivitet përfshin gjithashtu ndërtimin e lidhjeve me industritë dhe rrjetet e kontakteve profesionale për të ndihmuar të rinjtë të gjejnë dhe të shfrytëzojnë mundësi konkrete.
- 1.3. **Mentorimi dhe këshillimi individual:** Ofrimi i mbështetjes së personalizuar dhe këshillimit për të rinjtë, duke përfshirë ndihmën në hartimin e planeve të karrierës dhe identifikimin e mundësive për zhvillim profesional.
- 1.4. **Organizimi i ngjarjeve dhe punëtorive:** Organizimi i ngjarjeve dhe punëtorive që janë të orientuara drejt tregut të punës, duke përfshirë seminare, takime me punëdhënës të mundshëm përmes panairëve të punës, dhe sesione informuese me profesionistë të suksesshëm nga fusha të ndryshme.
- 1.5. **Zhvillimi i aftësive të buta:** Përmirësimi i aftësive të buta të të rinjve, si komunikimi, menaxhimi i kohës dhe bashkëpunimi, si dhe zhvillimi i aftësive të tjera që janë të rëndësishme për të arritur sukses në profesionet e tyre të zgjedhura.
- 1.6. **Përgatitja e tyre në kërkimin e punës:** Ofrimi i mbështetjes për të rinjtë në përgatitjen e CV-ve, letrave motivuese, përgatitjes për intervista pune, kërkimin e mundësive të punës nëpërmjet platformave të specializuara dhe rrjeteve profesionale.

Këto aktivitete janë të dizajnuara për të mbështetur të rinjtë në përgatitjen dhe integrimin e tyre në tregun e punës, duke i ndihmuar ata të bëhen pjesëmarrës aktivë dhe të suksesshëm në ekonominë lokale dhe më gjerë.

Objektivi specifik 2: Përforsimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale.

Aktivitetet e parapara për realizimin e këtij objekti përfshijnë:

- 2.1. **Krijimi i platformave dhe forumeve:** Organizimi i takimeve, forumeve dhe aktiviteteve të hapura që ofrojnë një hapësirë për të rinjtë në nivel lokal për të shkëmbyer ide, shprehur pikëpamjet e tyre dhe marrë pjesë aktivisht në diskutime rreth çështjeve që prekin komunitetin.
- 2.2. **Inkurajimi i përfaqësimit të të rinjve në institucionet vendore:** Nxitja dhe mbështetja e të rinjve për të marrë pjesë në organet vendimmarrëse dhe grupet këshillimore, duke përfshirë këshillat lokale, OJQ-të e të rinjve, organizatat kulturore dhe sportive, si dhe në struktura të tjera vendimmarrëse.

- 2.3. **Ofrimi i trajnimeve dhe aftësive për angazhimin civil:** Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve që furnizojnë të rinjtë me aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në aktivizmin social dhe për t'u angazhuar në proceset demokratike dhe qytetare
- 2.4. **Krijimi i partneriteteve me organizatat rinore dhe shoqërinë civile:** Bashkëpunimi me organizata rinore dhe shoqërinë civile për të organizuar evente, projekte dhe fushata që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale.
- 2.5. **Përdorimi i teknologjisë dhe mediave sociale:** Shfrytëzimi i teknologjisë dhe mediave sociale për të komunikuar dhe mobilizuar të rinjtë për të marrë pjesë në diskutime dhe procese vendimmarrëse, përfshirë përdorimin e platformave specifike të mediave sociale dhe aplikacioneve të dedikuara për këtë qëllim.
- 2.6. **Krijimi i politikave dhe strukturave që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve:** Zhvillimi dhe zbatimi i politikave lokale që promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe qytetare, duke përfshirë politikat për të rinjtë dhe forume të rinisë.

Këto aktivitete synojnë të forcojnë zërin dhe ndikimin e të rinjve në zhvillimet lokale, duke i bërë ata pjesëmarrës aktivë dhe vendimmarrës në jetën politike dhe sociale të komunitetit të tyre.

Objektivi specifik 3: Promovimi i një stili jetese të shëndetshëm dhe ofrimi i shërbimeve për mirëqenien e të rinjve.

Aktivitetet e parapara për realizimin e këtij objekti përfshijnë:

- 3.1. **Organizimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësim:** Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësim që nxisin një stil jetese të shëndetshme. Këto programe do të përfshijnë informacion mbi ushqimin e shëndetshëm, rëndësinë e aktivitetit fizik, rëndësinë e gjumit të mirë dhe teknikat e menaxhimit të stresit.
- 3.2. **Ofrimi i këshillimit individual dhe ndihmës për të rinjtë:** Sigurimi i këshillimeve individuale dhe ndihmës për të rinjtë për të ndjekur një stil jetese të shëndetshme, duke përfshirë ndihmën në përcaktimin e qëllimeve personale të mirëqenies dhe strategjitë për t'i arritur ato.
- 3.3. **Organizimi i aktiviteteve fizike dhe sportive:** Organizimi i një game të gjerë aktiviteteve fizike dhe sportive, duke përfshirë turne sportive, gara, leksione të ushtrimeve dhe programe sportive të përhershme që inkurajojnë të rinjtë të mbeten aktivë.
- 3.4. **Krijimi i ambienteve të shëndetshme:** Sigurimi dhe përmirësimi i ambienteve të shëndetshme në shkolla, në komunitet dhe në hapësirat publike, duke përfshirë ofrimin e ushqimeve të shëndetshme në institucione arsimore dhe hapësira për aktivitete sportive në komunitet.

- 3.5. **Përdorimi i teknologjisë për promovimin e shëndetit:** Zhvillimi dhe implementimi i aplikacioneve dhe platformave digjitale që inkurajojnë dhe ndihmojnë të rinjtë të monitorojnë dhe përmirësojnë shëndetin e tyre, duke përfshirë aplikacione për trajnime fizike dhe monitorimin e ushqyerjes.
- 3.6. **Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të specializuara:** Sigurimi i qasjes në shërbime shëndetësore të specializuara për të rinjtë, duke përfshirë shërbime psikologjike, kujdesin për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe kujdesin për probleme të veçanta shëndetësore të rinjve.

Këto aktivitete janë projektuar për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe në përmirësimin e praktikave të shëndetshme midis të rinjve, duke i bërë ata më të aftë për të menaxhuar shëndetin e tyre fizik dhe mendor në mënyrë efektive.

Objektivi specifik 4: Sigurimi i barazisë dhe pjesëmarrjes të të gjithë të rinjve në jetën sociale dhe politike të komunitetit, duke u përqendruar në mbështetjen e komuniteteve jo shumicë, të rinjve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

Aktivitetet e parapara për realizimin e këtij objekti përfshijnë:

- 4.1. **Krijimi i ambienteve gjithëpërfshirëse:** Sigurimi dhe përmirësimi i ambienteve në shkolla, institucione publike dhe komunitete që nxisin pjesëmarrjen aktive të të gjithë të rinjve. Kjo përfshin veçanërisht përmirësimin e qasjes për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë.
- 4.2. **Ndërtimi i partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile:** Bashkëpunimi dhe zhvillimi i partneriteteve me organizata të shoqërisë civile që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e të rinjve nga grupe të marginalizuara, duke përfshirë ato që punojnë me të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë nga komunitetet e varfëra, dhe të rinjtë me përvojë të ndryshme shoqërore dhe kulturore.
- 4.3. **Ofrimi i trajnimeve dhe fushatave informuese:** Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve informuese që ndihmojnë të rinjtë të kuptojnë të drejtat e tyre dhe proceset politike, si dhe të mësojnë mënyra për të marrë pjesë efektivisht në jetën sociale dhe politike të komunitetit.
- 4.4. **Inkurajimi i përfaqësimit të diversitetit në institucionet vendore:** Nxitja dhe mbështetja e përfaqësimit të diversitetit në mekanizmat shoqëror dhe institucionale dhe grupet këshillimore, duke siguruar që të rinjtë nga komunitetet e ndryshme dhe grupet e marginalizuara të kenë zë në proceset vendimmarrëse.
- 4.5. **Ofrimi i këshillimit:** Sigurimi i këshillimit të specializuar për të rinjtë që kanë nevojë për mbështetje të veçantë për të marrë pjesë në jetën sociale dhe politike të komunitetit, veçanërisht për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet jo shumicë.

Këto aktivitete janë thelbësore për të siguruar që të gjithë të rinjtë, pa marrë parasysh sfidat dhe pengesat që mund të kenë, të ndihen të përfshirë dhe të vlerësuar në zhvillimin e komunitetit të tyre.

Objektivi specifik 5: Inkurajimi i të rinjve për tu angazhuar në punë vullnetare për të kontribuar në mirëqenien e komunitetit.

Aktivitetet e parapara për realizimin e këtij objektivi përfshijnë:

- 5.1. **Promovimi i ndërgjegjësimit dhe motivimit:** Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe motivimit për të rinjtë përmes sesioneve informuese, takimeve të grupeve të diskutimit dhe prezantimeve të projekteve vullnetare që kanë një impakt pozitiv në komunitet. Këto aktivitete synojnë të nxisin interesin dhe përkushtimin e të rinjve ndaj veprimtarive vullnetare.
- 5.2. **Identifikimi i nevojave të komunitetit dhe të projekteve vullnetare:** Identifikimi i nevojave specifike të komunitetit dhe projekteve vullnetare që mund t'i adresojnë këto nevoja në mënyrë efikase. Kjo do të ndihmojë në orientimin e veprimtarive vullnetare për të arritur impaktin më të madh të mundshëm.
- 5.3. **Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare:** Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve të ndryshme vullnetare, të tilla si pastrimi i mjedisit, ndihma në komunitet, vizita në shtëpitë e të moshuarve dhe aktivitete të tjera që kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme të komunitetit.
- 5.4. **Krijimi i platformave vullnetare:** Zhvillimi i platformave të ndryshme për të rinjtë, duke përfshirë platformat digjitale, faqet e internetit dhe aplikacionet mobile, të cilat u mundësojnë të rinjve të gjejnë dhe të angazhohen në projekte vullnetare që u interesojnë.
- 5.5. **Ofrimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme:** Sigurimi i trajnimeve dhe aftësive të nevojshme për të rinjtë për të qenë efektivë dhe të suksesshëm në punën e tyre vullnetare. Këto përfshijnë aftësi të komunikimit, të menaxhimit të kohës dhe bashkëpunimit në grup.
- 5.6. **Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar:** Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar të të rinjve, duke i shpërblyer ata për përpjekjet dhe impaktin e tyre në komunitet. Kjo mund të përfshijë ceremoni të veçanta si shpallja e vullnetarit të vitit dhe të tjera forma të njohjes publike për përkushtimin e tyre.

Këto aktivitete janë esenciale për të ndërtuar një kulturë të angazhimit dhe të përgjegjësisë sociale në mesin e të rinjve, duke i bërë ata partnerë aktivë në zhvillimin dhe përmirësimin e komunitetit të tyre.

Objektivi specifik 6: Inkurajimi i të rinjve për t'u angazhuar në aktivitete fizike dhe sportive, si dhe në art, kulturë dhe trashëgimi kulturore.

Aktivitetet e parapara për realizimin e këtij objektiwi përfshijnë:

- 6.1. **Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve sportive:** Organizimi i turneve sportive, garave dhe aktiviteteve të ndryshme sportive për të rinjtë, duke përfshirë futbollin, basketbollin, volejbollin dhe sporte të tjera popullore. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara do të jetë një fokus i veçantë për të siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse.
- 6.2. **Ofrimi i programeve dhe i kurseve artistike dhe kulturore:** Organizimi i kurseve dhe i programeve të ndryshme për të rinjtë në fushat e artit, muzikës, teatrit, letërsisë, vallëzimit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore. Këto do të përfshijnë punëtori kreative dhe vizita studimore për të stimuluar interesin dhe zhvillimin artistik të të rinjve.
- 6.3. **Krijimi i ambienteve mbështetëse për aktivitetet alternative:** Sigurimi i hapësirave dhe resurseve që mundësojnë të rinjtë të eksplorojnë dhe zhvillojnë interesat e tyre në aktivitete alternative, si ekskursione në natyrë, udhëtime kulturore, aktivitete gjuhësore dhe studime të thella kulturore.
- 6.4. **Organizimi i eventeve kulturore dhe festivaleve rinore:** Organizimi i eventeve kulturore, festivaleve rinore dhe ngjarjeve komunitare që promovojnë diversitetin kulturor dhe artistik. Këto ngjarje synojnë të inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete dhe përmbajtje të ndryshme artistike dhe kulturore.
- 6.5. **Përdorimi i teknologjisë për të inkurajuar pjesëmarrjen:** Shfrytëzimi i mediave sociale dhe teknologjisë për të promovuar dhe nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete fizike, sportive, artistike dhe kulturore. Kjo përfshin krijimin e platformave digjitale dhe të aplikacioneve që lehtësojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave midis të rinjve.

Këto aktivitete janë projektuar për të inkurajuar një stil jetese të shëndetshme dhe aktive, si dhe për të rritur angazhimin e të rinjve në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të komunitetit të tyre.

Objektiwi specifik 7: Mbështetje e nismave që promovojnë ekonominë e gjelbërt dhe mjedise të pastërta dhe të gjelbërta.

Aktivitetet e parapara për realizimin e kësaj objektive përfshijnë:

- 3.1. **Inkurajimi i nismave për energjinë e ripërtëritshme:** Mbështetja dhe promovimi i investimeve në projekte për energjinë e ripërtëritshme, si instalimet e paneleve diellore, turbina të erës dhe teknologji të tjera që kontribuojnë në prodhimin e energjisë së qëndrueshme.
- 3.2. **Promovimi i transportit ekologjik:** Inkurajimi i përdorimit të mjeteve të transportit të qëndrueshëm si transporti publik, biçikletat, makinat elektrike dhe modalitete të tjera transporti që reduktojnë emetimin e gazrave të dëmshme.

- 3.3. **Inkurajimi i praktikave ekologjike për bizneset:** Nxitja e bizneseve për të zbatuar praktika të qëndrueshme të biznesit që përfshijnë reciklimin, përdorimin e materialeve të riciklueshme dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit.
- 3.4. **Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe të edukimit:** Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe të edukimit për publikun rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit të burimeve të qëndrueshme. Këto fushata do të përfshijnë programe edukative në shkolla dhe aktivitete në komunitet.
- 3.5. **Inkurajimi i investimeve të qeverisë lokale në projekte mjedisore:** Mbështetja e politikave dhe nismave qeveritare që inkurajojnë investime nga qeveria lokale dhe të rinjtë në projekte mjedisore, duke përfshirë ofrimin e granteve dhe politika të tjera mbështetëse.
- 3.6. **Përdorimi i teknologjisë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit:** Shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të monitoruar dhe mbrojtur mjedisin. Kjo përfshin përdorimin e aplikacioneve digjitale për raportimin e ndotjes së mjedisit dhe të platformave për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mjedisore.

Duke implementuar këto aktivitete të përcaktuara, qeverisja komunale, bizneset, organizatat joqeveritare, klubet sportive, grupet joformale dhe individët do të kontribuojnë në një ekonomi më të gjelbër dhe në krijimin e mjediseve më të shëndetshme dhe më të gjelbërta për të gjithë.

4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë elementë thelbësorë në zbatimin efektiv të strategjisë për rininë në komunën e Ferizajt. Këto procese sigurojnë që strategjia të jetë dinamike dhe të përshtatet me ndryshimet dhe nevojat e reja që mund të lindin gjatë implementimit të saj. Përdorimi i një sistemi objektiv dhe sistematik për të monitoruar dhe vlerësuar aktivitetet dhe rezultatet është jetik për të garantuar suksesin e strategjisë.

Përfshirja e indikatorëve të suksesit: Përcaktimi dhe përdorimi i indikatorëve të suksesit të paracaktuar janë esenciale për të vlerësuar progresin, për të identifikuar sfidat dhe për të zbuluar mundësitë për përmirësim. Këta indikatorë mund të përfshijnë:

- **Ritmin e rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete rinore:** Matja e shtimit të numrit të të rinjve që angazhohen në aktivitete të ndryshme rinore.
- **Hapësirën dhe përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse:** Vlerësimi i mënyrës dhe shkallës së përfshirjes së të rinjve në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre dhe në zhvillimin komunitar.

Plani i vlerësimit: Përcaktimi i një plani të qartë për vlerësimin periodik të zbatimit të strategjisë dhe arritjes së objektivave është thelbësor. Ky plan duhet të përfshijë metodologjitë dhe mjetet

specifike për të matur ndikimin dhe përceptimin e strategjisë nga palët e interesit, duke përfshirë anketat, intervistat, mbledhjet e fokus-grupeve dhe metodat e tjera të kërkimit.

Roli i Komunës së Ferizajt: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Ferizajt do të jetë bartësi kryesor, zbatuesi, implementuesi dhe mbikëqyrësi i kësaj strategjie. Kjo do të sigurojë që të gjitha aktivitetet dhe iniciativat të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullohen sipas rezultateve të vlerësimit për të maksimizuar efektivitetin e tyre.

Nëpërmjet këtyre proceseve të monitorimit dhe vlerësimit, strategjia për rininë synon të bëhet një dokument i gjallë që reflekton dhe përshtatet me kërkesat e ndryshme dhe të vazhdueshme të komunitetit të të rinjve në Ferizaj, duke u siguruar atyre mundësitë më të mira për zhvillim personal dhe kontribut në komunitet.

5. MIRATIMI DHE ZBATIMI

Miratimi dhe zbatimi i strategjisë për rininë janë hapat thelbësorë për të siguruar që synimet dhe objektivat e planifikuara të realizohen me sukses. Procesi do të përfshijë disa faza të qarta dhe të strukturuar për të garantuar një qasje efektive:

1. **Përgatitja e dokumentit final të strategjisë:** Kjo fazë përfshin finalizimin e dokumentit të strategjisë, duke siguruar që të gjitha pjesët të jenë të qarta, të plotësuara, të reflektojnë nevojat dhe pritjet e të rinjve, si dhe të komunitetit më të gjerë.
2. **Prezantimi para Komitetit për Politikë dhe Financa:** Strategjia do të prezantohet për rishikim dhe sugjerime para Komitetit për Politikë dhe Financa, i cili do të ofrojë orientime dhe korrigjime të mundshme përpara se të procedohet më tej.
3. **Prezantimi para Kuvendit të Komunës dhe dërgimi i dokumentit në diskutim publik:** Pas miratimit fillestar nga komiteti, dokumenti i strategjisë do të prezantohet para Kuvendit të Komunës për një diskutim më të gjerë. Ky prezantim do të jetë i hapur për publikun për të marrë pjesë dhe të ofrojë komente dhe sugjerime.
4. **Miratimi nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt pas rekomandimeve:** Pas diskutimit publik dhe integritetit të të gjitha sugjerimeve dhe rekomandimeve të nevojshme, dokumenti i strategjisë do të dërgohet për miratim përfundimtar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt.
5. **Nisja e zbatimit të strategjisë bazuar në planin e veprimit:** Pas miratimit, zbatimi i strategjisë do të nisë të zbatohet duke u mbështetur në një plan të detajuar veprimi. Ky plan do të përfshijë qartësisht të gjitha aktivitetet, kohëzgjatjet e tyre, përgjegjësitë dhe burimet e nevojshme për secilin aktivitet, si dhe do të prezantohet në kuvend për miratim. Planifikimi i veprimit do të jetë në harmoni të plotë me qëllimet dhe objektivat e strategjisë dhe do të sigurojë pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha palët e interesit për të garantuar një implementim të suksesshëm.

Kjo qasje e strukturuar siguron një proces të qartë dhe të organizuar që mundëson jo vetëm miratimin dhe zbatimin e duhur të strategjisë, por gjithashtu edhe përfshirjen e gjerë dhe monitorimin efektiv për të garantuar arritjen e objektivave të saj.

6. KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI I VAZHUESHËM

Komunikimi dhe angazhimi i vazhdueshëm janë jetikë për suksesin e strategjisë së përfshirjes dhe mbështetjes së rinisë në Komunën e Ferizajt. Një plan komunikimi efektiv dhe i gjithëpërfshirë është thelbësor për të mbajtur të rinjtë dhe palët e interesit të informuar rreth zhvillimeve, arritjeve dhe mundësive për pjesëmarrje.

Zhvillimi dhe zbatimi i planit të komunikimit: Do të zhvillohet dhe zbatohet një plan i detajuar komunikimi që përdor platforma dhe kanale të ndryshme mediale, duke përfshirë:

- **Rrjetet sociale:** Përdorimi i Facebook, Instagram, Twitter dhe platformave të tjera për të ndarë informacione të rëndësishme, njoftime për ngjarjet dhe arritjet e rëndësishme.
- **Uebfaqet zyrtare:** Përditësimi i vazhdueshëm i uebfaqes së komunës me informacione të reja, dokumente strategjike dhe mundësi për angazhim.
- **Media tradicionale:** Bashkëpunimi me mediat lokale dhe kombëtare për të siguruar që informacionet e rëndësishme arrijnë një audiencë më të gjerë.

Nxitja e angazhimit të vazhdueshëm: Strategjia do të përfshijë gjithashtu zhvillimin e programeve dhe të aktiviteteve që lejojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe në zbatimin e projekteve. Kjo do të realizohet përmes:

- **Organizimit të punëtorive dhe takimeve konsultative:** Këto sesione do të ofrojnë mundësi për të rinjtë që të marrin pjesë direkt në diskutime, të japin mendimet e tyre dhe të ndikojnë në vendimet që i prekin.
- **Platformave interaktive online:** Krijimi i platformave online ku të rinjtë mund të bashkëveprojnë, të shprehin idetë dhe sugjerimet e tyre, si dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në mënyrë virtuale.

Rëndësia e kësaj përfshirjeje qëndron në krijimin e një ndjenje pronësie dhe përfshirjeje për të rinjtë, e cila është thelbësore për realizimin e objektivave të strategjisë. Kjo gjithashtu ndihmon në ndërtimin e një komuniteti më të përfshirë dhe të angazhuar, duke e bërë rininë jo vetëm pjesëmarrëse por edhe bashkëpunëtoare në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

“Ky projekt u mbështet përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit (ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.”



SHTOJCA 1

PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR RININË

2024 – 2027

Ky dokument është hartuar në bashkëpunim me grupin punues të formuar sipas vendimit Nr. 61/24 të datës 21.03.2024 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, dhe takimeve specifike të mentoruar nga SWOK Kosova me palë të tjera të interesit.

Plani i Veprimit 2024 – 2027 është realizuar me përkrahjen e projektit “Mbështetja e të rinjve/të rejave nga komunitetet pakicë me aktivitete psiko-sociale, emocionale, si dhe fuqizimi, integrimi i tyre në aktivitete kulturore në Rajonin e Ferizajt, faza e dytë.” Ky projekt është financuar nga iniciativa ‘Komuna për të rinjtë,’ e cila mbështetet nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social, të administruar nga Banka Botërore dhe implementuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit të Komunitetit (CDF), dhe participuar financiarisht nga Komuna e Ferizajt.

Përmbledhje ekzekutive

Plani i Veprimit për Rininë në Komunën e Ferizajt paraqet një përpjekje të qartë dhe të strukturuar për të adresuar në mënyrë efektive sfidat dhe për të shfrytëzuar mundësitë që lidhen me rininë e kësaj zone. Si një iniciativë e rëndësishme dhe strategjike, ky plan është hartuar me një qasje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në të dhëna të mbledhura përmes një hulumtimi të detajuar, "Vlerësimi i Nevojave të Rinisë në Komunën e Ferizajt", duke siguruar që perspektiva dhe nevojat e të rinjve të jenë në zemër të politikave dhe programeve që zhvillohen.

Ky plan është i mbështetur nga projekti "Municipalities for Youth," i financuar nga Qeveria e Japonisë dhe Komuna e Ferizajt, duke treguar kështu një përkushtim të thellë për të adresuar nevojat dhe sfidat e të rinjve në Ferizajt, si dhe duke u siguruar atyre një të ardhme më të ndritur. Përpjekja për të zhvilluar një mjedis ku të rinjtë mund të zhvillohen në mënyrë të plotë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, tregon një synim për të krijuar një platformë solide për ndryshim pozitiv dhe zhvillim të qëndrueshëm në komunitet.

Komuna e Ferizajt, e përkushtuar për t’u njohur me nevojat e të rinjve nga ky qytet në zhvillimin dhe mirëqenien e tyre, ka vendosur si prioritet maksimizimin e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve që mbështesin jo vetëm aspektet ekonomike të jetës së tyre, por edhe ato sociale dhe emocionale.

Në këtë kontekst, plani synon të ndërtojë dhe të forcojë infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur shërbime të tilla si arsimin dhe trajnimin profesional, sportin dhe aktivitetet rekreative, si dhe shërbimet e këshillimit dhe mbështetjes së shëndetit mendor.

Plani ka përcaktuar prioritetet kryesore, të cilat, kanë buruar nga rezultati i hulumtimit që ka paraprirë atë. Prioritetet kryesore të planit janë të përqendruara jo vetëm në adresimin e sfidave të përditshme, por edhe në maksimizimin e potencialit të të rinjve si forca për ndryshim pozitiv.

Prioritetet kryesore të planit

Prioritetet kryesore të planit janë të përqendruara jo vetëm në adresimin e sfidave të përditshme, por edhe në maksimizimin e potencialit të të rinjve si forca për ndryshim pozitiv. Këto përfshijnë:

1. **Edukimi dhe trajnimet profesionale:** Të rinjtë kanë shprehur nevojën për më shumë mundësi në edukimin formal dhe trajnime profesionale që i përgatisin ata për tregun e punës. Kjo përfshin zgjerimin e ofertës së programeve edukative që janë të lidhura me nevojat aktuale të tregut të punës, si dhe sigurimin e trajnimeve praktike dhe praktikave profesionale.
2. **Përfshirja dhe përfaqësimi në komunitet:** Përfshirja më e madhe e të rinjve në vendimmarrjen komunitare dhe aktivitetet që ndikojnë në jetën e tyre. Kjo do të thotë të sigurohet që të rinjtë të jenë të përfaqësuar në forumet vendimmarrëse, të kenë qasje në platforma ku mund të shprehin mendimet dhe të jenë pjesë e ndryshimeve në komunitet.
3. **Siguria dhe mbrojtja në komunitet:** Siguria mbetet një shqetësim i madh për të rinjtë, që përfshin sigurinë në shkolla dhe në hapësirat publike. Prioritetet në këtë fushë përfshijnë masat për të parandaluar dhunën dhe bullizmin, si dhe të rrisin sigurinë rrugore dhe në mjediset ku të rinjtë kalojnë kohën.
4. **Zhvillimi i aktiviteteve dhe programeve kulturore, rekreative, fizike dhe sportive:** Promovimi dhe mbështetja e aktiviteteve dhe programeve që ofrojnë mundësi për të rinjtë të angazhohen në kulturë, art, sport dhe aktivitete rekreative. Kjo përfshin organizimin e eventeve kulturore dhe artistike, ofrimin e mundësive për të marrë pjesë në sport dhe lojëra, si dhe sigurimin e hapësirave për të eksploruar dhe shprehur kreativitetin personal.
5. **Promovimi i shëndetit mendor dhe i mirëqenies:** Nevoja për të adresuar çështjet e shëndetit mendor dhe ofrimin e mbështetjes për të rinjtë që përballen me sfida të shëndetit mendor. Duke e kuptuar rëndësinë kritike të mirëqenies psikologjike për zhvillimin e të rinjve, ky objektivi synon të zgjerojë dhe të përmirësojë qasjen në shërbimet e këshillimit, mbështetjen e psikologut ose të punëtorit social në institucionet e ndryshme kulturore, edukative apo shëndetësore.

6. **Fuqizimi i të rinjve të komuniteteve jo shumicë:** Socializimi i të rinjve të komuniteteve jo shumicë në aktivitetet e organizuara nga komuniteti i të rinjve aktiv në programet kulturore, rinore dhe sportive.

Hyrje

Kosova shquhet për dinamizmin dhe potencialin e saj të jashtëzakonshëm rinor, me një moshë mesatare prej vetëm 26 vjeç, që e bën atë shtetin me popullsinë më të re në Ballkan dhe në Evropë. Kjo popullsi rinore përbën rreth 30% të gjithë popullsisë, duke ofruar një mundësi unike për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në këtë kontekst, angazhimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në shoqëri, veçanërisht në Ferizaj, janë thelbësore për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe prosperuese.

Të rinjtë në Ferizaj, dhe në përgjithësi në Kosovë, përballojnë sfida të ndryshme që përfshijnë mungesën e shërbimeve cilësore, aktiviteteve rekreative dhe kulturore, si dhe mundësive të punësimit dhe platformave për angazhim qytetar. Plan Komunal i Veprimit për Rininë 2024 - 2027 në Ferizaj synon të adresojë këto çështje përmes një sërë iniciativash dhe programesh që përqëndrohen në fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, si dhe përmirësimin e qasjes në arsim, shëndet dhe mundësitë e punësimit.

Hulumtimi: Vlerësimi i nevojave të rinisë për vitin 2024 - Komuna Ferizaj

Në vlerësimin e nevojave të rinisë në Ferizaj për vitin 2024, u zbuluan disa aspekte kyçe që reflektojnë situatën dhe pritjet e të rinjve në këtë komunë. Analiza demografike tregoi një përfshirje të ulët të të rinjve në organizata, OJQ dhe klube, me vetëm 28.4% të tyre që raportuan se janë pjesë e ndonjë grupi të organizuar. Kjo tregon një mungesë të mundësive ose një heshtje ndaj angazhimit në aktivitete dhe iniciativa që mund të ofrojnë zhvillim personal dhe profesional.

Përveç kësaj, siguria shfaqet si një nga shqetësimet më të mëdha për të rinjtë, veçanërisht në mjediset arsimore. Të rinjtë ndjejnë nevojë për masa më të rrepta të sigurisë dhe për një reagim më të fortë ndaj atyre që çenojnë sigurinë e tyre, gjë që thekson rëndësinë e ndërtimit të mjediseve të sigurta edukative.

Nga ana tjetër, hulumtimi tregon se të rinjtë kanë një interes të lartë për arsimimin joformal dhe shërbimet e punësimit, duke reflektuar një kërkesë për më shumë programe dhe trajnime që lidhen me zhvillimin e karrierës. Ky interes i theksuar në zhvillimin profesional dhe në krijimin e mundësive të punësimit përcakton një fushë të rëndësishme ku mund të përqendrohen përpjekjet për të mbështetur aspiratat e tyre.

Në përgjithësi, teknologjia dhe mediat sociale janë të preferuara si mjetet kryesore të informimit për të rinjtë, çka tregon një mundësi për të përdorur këto kanale për të përmirësuar strategjitë e komunikimit dhe të informimit për të rinjtë. Kjo preferencë ndikon në mënyrën se si informacioni duhet të shpërndahet për të arritur efektivisht këtë audiencë dhe për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme që mund të ofrohen nga komuniteti ose nga iniciativat private.

Hulumtimi, po ashtu, tregoi një nevojë të qartë për mbështetje në aspektin e shëndetit mendor dhe emocional të të rinjve. Shumë prej tyre ndjejnë mungesë të qasjes në shërbime të këshillimit dhe mbështetje psikologjike, gjë që është kruciale për mirëqenien e tyre të përgjithshme. Përballja me stresin e shkollës, presionet sociale dhe sfidat personale, pa mbështetje adekuate, mund të çojnë në probleme afatgjata të shëndetit mendor. Kjo situatë thekson nevojën për të shtuar burimet dhe

qasjen në shërbime të specializuara që mund të ndihmojnë të rinjtë të menaxhojnë sfidat e tyre në mënyra më efektive dhe të shëndetshme.

Këto gjetje, e shumë të tjera të dala nga hulumtimi i fundit, padyshim se do të shërbejnë si një udhërrëfyes për zhvillimin e strategjive të ardhshme dhe për hartimin e planeve të veprimit që synojnë të përmirësojnë kushtet dhe mundësitë për të rinjtë në Ferizaj, duke u përqendruar në adresimin e nevojave të tyre të theksuara për siguri, angazhim, arsimim, mbështetje emocionale dhe zhvillim profesional.

Bashkërendimi me politikat vendore, kombëtare dhe evropiane

Fuqizimi i rinisë në Ferizaj kërkon një qasje të koordinuar dhe të bashkërenduar që përfshin koordinimin dhe partneritetin ndërmjet sektorit publik, privat dhe joqeveritar, por edhe bashkëpunimin me institucionet arsimore, kulturore dhe organizatat rinore. Bashkërendimi me politikat vendore, kombëtare dhe evropiane siguron që veprimet janë të integruara dhe mbështesin një vizion të përbashkët për të ardhmen e rinisë. Kjo përfshin sinkronizimin me iniciativat e komunës së Ferizajt, *Strategjinë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në komunën e Ferizajt 2024 - 2027*, politikat kombëtare rinore, si *Strategjia Kombëtare e Rinisë miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*, si dhe direktivat dhe normat e Bashkimit Evropian, për të maksimizuar efikasitetin dhe për të ndërtuar një platformë të qëndrueshme për zhvillimin e rinisë.

Promovimi i shëndetit mendor dhe parandalimi i çrregullimeve mendore është një ndër *Synimet e Objektivave Evropiane për Rininë* të përcaktuara nga *Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027*. Objektivat: Shëndeti Mendor dhe Mirëqenia dhe Lëvizja e Rinisë Rurale përpara.

Përdorimi i Analizës SWOT për Orientimin Strategjik

Analiza SWOT ofron një mjet të fuqishëm për të kuptuar forcat, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që ndikojnë në rininë e Ferizajt. Kjo analizë mundëson organizatat dhe bartësit e detyrave të identifikojnë burimet e brendshme që mund të mobilizohen dhe sfidat e jashtme që duhet të adresohen. Përmes identifikimit të aspekteve ku rinia e Ferizajt ka avantazhe konkurruese dhe zonave ku janë të ekspozuar ndaj rreziqeve, planifikuesit mund të krijojnë strategji të fokusuara që promovojnë reziliencën dhe adaptimin.

Monitorimi dhe vlerësimi

Plani parashikon krijimin e një mekanizmi të pavarur monitorimi për të vlerësuar se sa mirë janë vënë në jetë dispozitat e saj. Ky mekanizëm monitorimi, i cili konsiderohet si një ndër pikat kryesore dhe më të forta të planit, përbëhet nga:

1. Përfaqësuesi/ja nga DKRS,

2. Përfaqësuesi/ja nga

Procesi i monitorimit rregullohet me anë të metodologjisë "scrum". Kjo metodologji është adaptuar për nevojat e PKVR-së dhe nënkupton që ekipi i monitorimit do të ketë takime të rregullta në baza mujore çdo muaj me datë 15 (nëse qëllon vikend apo festë, shtyhet për ditën e radhës pasuese).

Ekipi i monitorimit për tre vite me radhë do të hartojë gjashtë raporte vlerësimi të periudhës, të cilat do të publikohen në rrjetet zyrtare të Komunës së Ferizajt dhe organizatave partnere, si dhe në media.

Ekspertiza teknike është ofruar nga SWOK Kosova. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e SWOK Kosova dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i donatorëve.



Shtojca 1: PLANI I VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027

PRIORITETI I	AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteteve	INDIKATORËT	INSTITUCIONI/ET PËRGJEGJËS/E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/ PAJISJET	BUXHETI
Edukimi dhe trajnimet profesional e	1.1 Krijimi i qendrave të reja të trajnitit profesional	Zhvillimi dhe hapja e qendrave të reja që ofrojnë programe trajnimi në fushat ku ka kërkesë të lartë të tregut të punës.	Numri i qendrave të reja të hapura, numri i të rinjve të regjistruar.	Qendra e Inovacionit, Flutura Academy	DKRS	2025-2026	Pajisjet teknologjik e	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	1.2 Zgjerimi i programeve të praktikave profesionale	Bashkëpunimi me bizneset për të ofruar praktika të paguara për të rinjtë në fushat kyçe.	Numri i praktikave të krijuara, përqindja e praktikantëve që marrin oferta pune.	Zyrat regionale tt	Kompanitë private, Oda Ekonomike, bizneset lokale, DKRS	2024-2026	Marrëvesh je bashkëpu nimi, platforma të ndërmjetë simit	2,500 EUR x 3 = 7,500 EUR

	1.3 Programet e mentorimit dhe zhvillimit të aftësive	Implementimi i programeve të mentorimit për të rinjtë me profesionistë të suksesshëm në fushat e tyre.	Numri i mentorëve dhe të mentuarve	Qendrat e zhvillimit të karrierës (ose naj organ tek Zyra e punësimit	Universitetet , profesionistët e fushave përkatëse	2024-2027	Materialet edukative, hapësirat për takime	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	1.4 Rritja e ofertave edukative në teknologjinë informat	Zgjerimi i programeve edukative që fokusohen në TIK dhe zhvillimin e softuerit, duke përfshirë kodimin dhe sigurinë kibernetike.	Numri i kurseve të reja, numri i studentëve të regjistruar.	USHAF, DKRS	Kompanitë e TIK, organizatat ndërkombëtare	2024-2025	Laboratorët kompjuteri kë, softuerët	2,500 EUR x 3 = 7,500 EUR

	1.5 Nxitja e arsimit dhe trajnimeve në fushat e mjedisit dhe qëndrueshmërisë	Promovimi dhe ofrimi i programeve që adresojnë nevojat për zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.	Numri i programeve të reja, numri i pjesëmarrësve në aktivitete mjedisore.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Shoqatat alpiniste bjakshkatore ferizajase	Organizatrat mjedisore, institutet kërkimore	2024-2027	Materialet didaktike, pajisjet për kërkimin e terrenit	2,500 EUR x 3 = 7,500 EUR
PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027								
PRIORITETI II	AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteteve	INDIKATORËT	INSTITUCIONI/ET PËRGJEGJËS/E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/ PAJISJET	BUXHETI
Përfshirja dhe përfaqësim	2.1 Trajnimet për aftësitë e	Organizimi i trajnimeve për të rinjtë për të	Numri i të rinjve të trajnuar,	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;	Shkollat fillore në	2024-2027	Materiale trajnuese,	1,500 EUR x3

i në komunitet	avokimit dhe përfaqësimit	zhvilluar aftësitë e tyre në avokim, përfaqësim publik dhe artikulum të qartë të kërkesave të tyre.	përmirësimi i aftësive të komunikimit dhe avokimit.	Qendrat Rinore, Qendra Edukative Arsimore Dubrave;	qytetin e Ferizajit		ekspertë të fushës	=4,500 EUR
	2.2 Fushata sensibilizuese për rëndësinë e angazhimit rinor	Zhvillimi i fushatave mediatike dhe aktiviteteve sensibilizuese që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.	Numri i fushatave të realizuara, rritja e ndërgjegjësim it në komunitet.	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Mediat lokale, shkollat	2024-2027	Hapësira për mbajtjen e forumeve, pajisje audio/vizu ale	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

	2.3 Programi i mentorimit për liderët e rinj	Bashkim i të rinjve me liderë lokalë dhe ekspertë në fusha të ndryshme për të ndërtuar udhëheqës të ardhshëm të komunitetit.	Numri i të rinjve dhe mentorëve të përfshirë, historitë e suksesit, projekte të realizuara.	Organizatrat rinore në komunën e Ferizaj (SWOK, Toka, Rrjeti i OJQ-ve, etj.)	Bizneset lokale, mentorët ekzistues	2024-2027	Materialet e mentorimit , hapësira për takime	2,500 EUR x 3 = 7,500 EUR
	2.4 Mbështetja e takimeve të rregullta të këshillit të nxënësve në shkolla	Fuqizimi i këshillave të nxënësve në shkollat e mesme për të organizuar mbledhje rregullisht ku diskutohen dhe adresohen çështjet e nxënësve.	Frekuenca e mbledhjeve, numri i të rinjve të përfshirë, numri i çështjeve të trajtuara dhe të zgjidhura.	Ministria e Arsimit DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit - Ferizaj	Këshillat e nxënësve, drejtoritë e shkollave, prindërit	2024 - 2027 Çdo gjashtë muaj	Mjete komunikimi, hapësirat e mbledhjeve (zyret e shkollave)	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

	2.5 Nxitja e pjesëmarrjes rinore në Politikë	Organizimi i seminareve dhe takimeve me politikanë lokalë për të diskutuar rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në politikë dhe për të inkurajuar kandidaturat e tyre për poste vendimmarrëse.	Numri i të rinjve të interesuar për politikë, pjesëmarrja në zgjedhje si kandidatë.	Partitë politike; Komuna e Ferizajit	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal	2024-2025	Materialet informues e, vendet për takime	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

2.6 Lansimi i fushatës "Zëri ynë në qytet"

Lansimi i një fushate të gjerë sensibilizuese që synon të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve në diskutimet dhe vendimmarrjet për çështjet urbane që ndikojnë në jetën e përditshme. Fushata do të përfshijë mediat sociale, seminare, dhe panele diskutimi me zyrtarë lokal.

Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në takime publike dhe konsultime, shtimi i propozimeve të tyre në plane dhe projekte urbane.

Organizatrat lokale; Komuna e Ferizaj; KVRL

Mediat lokale, shkollat, universitetet

2024-2025

Materialet promovuese, hapësira për ngjarje, platforma online

1,500 EUR x3 =4,500 EUR

PRIORITETI III	AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteteve	INDIKATORËT	INSTITUCIONI/ET PËRGJEGJËS/E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/ PAJISJET	BUXHETI
Siguria dhe mbrojtja në komunitet	3.1 Hulumtimi për matjen e incidenteve dhe rasteve në shkolla	Realizimi i një hulumtimi për të frekuencën e incidenteve dhe sigurisë në shkolla.	Raporti i hulumtimit, të dhënat e mbledhura, rekomandime t për përmirësim.	DKA Ferizaj,	Organizatrat lokale që merren me hulumtime (SWOK, Ubo Consulting, etj.)	Çdo dy vite	Mjete hulumtimi, pyetësor, programet e analizimit të të dhënave	3,500 EUR
	3.2 Sistemi i monitorimit të sigorisë në shkolla	Instalimi i kamerave të sigorisë dhe sistemeve të monitorimit për të rritur sigurinë në ambientet shkollore.	Numri i kamerave të instaluar, ulja e incidenteve të sigorisë.	Drejtoria e Arsimit, Komiteti për Politikë dhe Financa	Kompanitë e sigurimit, organizatat lokale	2025-2026	Kamerat e sigurisë, sistemet e monitorimit	

	3.3 Trajnime për menaxhimin e situatave emergjente	Trajnimet për të rinjtë për të mësuar si të reagojnë në situata të emergjencave, përfshirë zjarret, tërmetet, dhe situatat e tjera kritike.	Numri i të rinjve të trajnuar, aftësia për të menaxhuar emergjencat.	Shkollat fillore, kryqi i kuq	Qendra e zjarrfikësve, ndihma e parë	2024-2027	Pajisjet e emergjencave, materialet edukative, modulet e trajnimit	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	3.4 Realizimi i trajnimeve rreth sigurisë kibernetike	Realizimi i punëtorive mbi ndërgjegjësimin e të rinjve lidhur me rreziqet e internetit, ngacmimeve	Numri i punëtorive të realizuara, përmirësimi i njohurive për	Organizatrat lokale që ofrojnë trajnime, Qendra e Inovacionit	Shkollat, kompanitë e IT	2024-2026	Materialet edukative, platforma online	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

		kibernetike, dhe praktikave të sigurta	sigurinë online.					
	3.5 Avokimi për raportimin e rasteve të sigurisë	Nxitja e një kulture ku të rinjtë dhe stafi i shkollës janë të inkurajuar dhe të mbështetur për të raportuar çdo rast të sigurisë apo bullizmit.	Rritja e rasteve të raportuara, përmirësimi i ndërgjegjësim it dhe reagimit ndaj incidenteve.	Ministria e Arsimit, DKA-të	Qendrat Rinore, Qendra e Inovacionit	2024-2026	Materialet edukative, platforma të raportimit	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	3.6 Rritja e përdorimit të SMIA për raportimin e rasteve në shkolla	Fushatë dhe aftësim praktik lidhur me rritjen e zbatimit të sistemit për menaxhimin e	Implementimi i sistemit, përdorimi i tij efektiv, numri i rasteve të	Ministria e Arsimit DKA-të	Shkollat model (që e përdorin SMIA-në në mënyrë	2024-2025	Software i SMIA, trajnime praktike për	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

		informatave (SMIA) për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të sigurisë në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme.	raportuara dhe të trajtuara.		efektive) , IT kompanitë		përdoruesit	
PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027								
PRIORITETI IV	AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteteve	INDIKATORËT	INSTITUCIONI/ET PËRGJEGJËS/E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/ PAJISJET	BUXHETI
Zhvillimi i aktiviteteve dhe programeve të kulturave, rekreative, fizike dhe sportive	4.1 Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve sportive	Organizimi i turnireve dhe garave sportive, duke përfshirë sportet si futboll, basketbolli, dhe volejboli, si dhe sporte	Numri i ngjarjeve, pjesëmarrja, përfshirja e personave me aftësi të kufizuara.	DKRS, DKA, Ferizaj, MKRS Klubet sportive	Handikos Ferizaj, Hendifer, OJQ Toka, SWOK, etj.	2025-2027	Fushat sportive, pajisjet	15,000 EUR x3 =45,000 EUR

		gjithëpërfshirëse të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.						
	4.2 Ofrimi i programeve dhe kurseve artistike dhe kulturore	Organizimi i kurseve në art, muzikë, teatër, vallëzim dhe artizanat, duke përfshirë punëtori kreative dhe vizita studimore.	Numri i kurseve të ofruara, pjesëmarrja e të rinjve.	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Shkollat, institutet kulturore, Teatri Adriana, AAKV Kastriotet, Galeria e arteve, HITHI, etj	2024-2027	Materiale artistike, hapësirat e kursit	10,000 EUR x3 =30,000 EUR

	4.3 Krijimi i ambienteve të mbështetëse për aktivitetet alternative	Sigurimi i hapësirave për aktivitete alternative si ekskursione natyrore dhe udhëtime kulturore.	Numri i aktiviteteve, pjesëmarrja e të rinjve.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit - Ferizaj	Organizatat e turizmit, parqet natyrore	2024-2027	Transporti, pajisjet për udhëtime	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	4.4 Organizimi i ngjarjeve kulturore dhe festivaleve rinore	Organizimi i festivaleve rinore që promovojnë diversitetin kulturor dhe artistik dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve.	Numri i festivaleve, pjesëmarrja dhe diversiteti i përmbajtjes.	DKRS- Ferizaj	Artistët lokalë, komunitetet e ndryshme kulturore	Çdo vit	Hapësirat për ngjarjet, materialet promovuese	5000 EUR x3 =15,000 EUR

	4.5 Përdorimi i teknologjisë për të inkurajuar pjesëmarrjen	Krijimi dhe promovimi i platformave digjitale për angazhimin e të rinjve në aktivitete sportive, kulturore dhe artistike.	Zhvillimi i aplikacioneve, numri i përdoruesve aktivë, ndërveprimet në platformë.	Qendra e Inovacionit	Kompanitë e IT, mediat lokale, rrjetet sociale	2024-2027	Software, pajisjet digjitale	500 EUR x3 =1,500 EUR
	4.6 Përmirësimi i ambienteve të lojërave dhe hapësirave publike	Përmirësimi i parqeve dhe hapësirave publike me instalime të reja për sporte dhe lojëra, të qasshme edhe për personat me aftësi të kufizuara.	Numri i hapësirave të qasshme të përmirësuara, frekuenca e përdorimit nga të rinjtë.	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Infrastrukturës	Kompanitë e ndërtimit, sponsorët	2026-2027	Pajisjet e lojërave, rritja e numrit të parqeve ekzistuese , etj.	Te mirren te dhena ne Drejtorine perkatese

		kufizuara, përfshirë zona të gjelbërta për relaksim.						
PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027								
PRIORITETI V	AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteteve	INDIKATORËT	INSTITUCIONI/ET PËRGJEGJËS/E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/ PAJISJET	BUXHETI
Promovimi i shëndetit mendor dhe mirëqenies:	5.1 Programe të edukimit rreth shëndetit mendor	Zhvillimi dhe implementimi i programeve edukative në shkolla dhe institucione të tjera, të fokusuara në ndërgjegjësimin për çështje të shëndetit mendor.	Numri i institucioneve të përfshira, numri i pjesëmarrësve.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Shkollat, universitetet, OJQ-të e fushes	2024-2027	Materialet edukative, trajnerët	3000 EUR x3 =9,000 EUR

	5.2 Qendra për këshillim dhe mbështetje	Themelimi i qendrave/zyreve të dedikuara për këshillim dhe mbështetje emocionale në lokacione të ndryshme në komunë.	Numri i qendrave të hapura, numri i diskutimeve të këshillimit të ofruara.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Klinika, spitalet, Qendrat e Shëndetit Mendor, Qendrat Rinore, Shkollat fillore dhe të mesme	2024-2027	Hapësirat e këshillimit, stafi profesional	3000 EUR x3 =9,000 EUR
	5.3 Programet e ndërgjegjësi mit dhe stigmatizimit	Fushata dhe aktivitete për ndërgjegjësimin kundër stigmatizimit të çështjeve të	Ulja e stigmatizimit, rritja e raporteve për çështje të	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Mediat, shkollat, universitetet	2024-2027	Materialet promovuese, mediat	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

		shëndetit mendor dhe promovimin e një qasjeje më të hapur dhe inkurajuese.	shëndetit mendor.					
	5.4 Sesionet informuese për ndërgjegjësimin dhe menaxhimin e stresit	Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e stresit dhe teknikat e relaksimit për të rinjtë.	Numri i trajnimeve të mbajtura, pjesëmarrja e të rinjve.	Qendra për Shëndetin Mendor, DKRS	Organizatrat partnere	2024-2027	Materialet trajnuese, trajnerët	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	5.5 Adaptimi i aplikacioneve rreth shëndetit	Adaptimi në gjuhën shqipe i aplikacioneve mobile që ofrojnë	Numri i shkarkimeve, përdoruesit aktivë,	Qendra e Inovacionit, DKRS	Kompanitë për IT, organizatat e shëndetit mendor	Aplikacionet për Android/IOS		1000 EUR x3 =3000 EUR

	mendor në gjuhën shqipe	këshilla, burime dhe mbështetje të ndërsjellë për shëndetin mendor të të rinjve.	feedbacku pozitiv.					
	5.6 Shtimi i psikologëve dhe punëtorëve social në shkolla	Rritja e numrit të psikologëve dhe punëtorëve socialë të vendosur në shkolla për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për nxënësit.	Numri i psikologëve dhe punëtorëve social të shtuar, ulja e rasteve të problemeve të shëndetit mendor.	Ministria e Arsimit, DKA,	Shkolla, QPS	2026-2027	Zyrat e këshillimit, pajisjet e punës, metodologji të e mbështetje s emocional e	

	5.7 Promovimi i Shërbimeve të QPS-së	Fushata për të rritur ndërgjegjësimin dhe përdorimin e shërbimeve të ofruara nga Qendra për Punë Sociale, duke përfshirë sesione informuese dhe materiale promovuese.	Rritja e informimit dhe shërbimeve të ofruara nga të rinjtë në QPS, shtimi i ndërgjegjësim it në komunitet.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, QPS	Mediat, institucionet edukative	2024-2027	Materialet promovuese, sesionet informuese	1,500 EUR x3 =4,500 EUR
	5.8 Promovimi i platformave ekzistuese për mbështetje emocionale	Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për të promovuar platformat	Rritja e numrit të thirrjeve dhe interaksioneve në këto platforma,	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Mediat, OJQ-të, shkollat, universitetet	2025-2027	Materialet promovuese, platformat digjitale	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

		ekzistuese si Linja e Jetës dhe të tjera që ofrojnë këshillim dhe mbështetje emocionale.	ulja e ndjesive të izolimit dhe depresionit tek të rinjtë.					
PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027								
PRIORITETI VI	AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteve	INDIKATORËT	INSTITUCIONI/ET PËRGJEGJËS/E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/ PAJISJET	BUXHETI
Fuqizimi i të rinjve të komuniteteve e jo shumicë	6.1 Organizimi i aktiviteve kulturore dhe sportive të përbashkëta	Organizimi i aktiviteve që përfshijnë pjesëmarrësit nga të gjitha komunitetet, përfshirë festivale,	Numri i aktiviteve të organizuara, pjesëmarrja e të rinjve nga komunitetet jo shumicë.	DKRS-, Zyra e Komuniteteve, Komiteti për Komunitete	Shkollat, klubet sportive, OJQ-të	2024-2027	Hapësira për realizimin e ngjarjeve, pajisjet sportive	1,500 EUR x3 =4,500 EUR

		garat sportive dhe ngjarje kulturore.						
	6.2 Programi i mentorimit për të rinjtë nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian	Zhvillimi i një programi të mentorimit që lidh të rinjtë nga këto komunitete me profesionistë në fusha të ndryshme për të ndihmuar në zhvillimin e karrierës dhe aftësive të tyre.	Numri i mentorëve dhe të mentuarve, raportet e suksesit të mentorimit.	DKRS	OIQ-të, bizneset lokale	2024-2027	Materialet e trajnimit, hapësira për takime	1,000 EUR x3 =3,000 EUR

	6.3 Trajnime për aftësim profesional për komunitetet jo-shumicë	Realizimi i trajnimeve që ofrojnë aftësim profesional dhe ndihmë në gjetjen e punës për të rinjtë nga komunitetet jo shumicë.	Numri i trajnimeve të ofruara, pjesëmarrja, rritja e punësimit.	Agjencia e Punësimit, Qendra për Aftësim Profesional	Bizneset lokale, OJQ-të	2026-2027	Mjete trajnuese, pajisje	4,000 EUR x3 =12,000 EUR
	6.4 Inkurajimi i pjesëmarrjes në organizata rinore dhe politike	Fushata për të inkurajuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve nga komunitetet jo shumicë në organizata rinore dhe politike lokale.	Numri i të rinjve të përfshirë, rritja e pjesëmarrjes në aktivitete politike dhe vendimmarrje .	Keshilli i Veprimit Rinor Lokal- Ferizaj	Partitë politike, OJQ-të rinore	2024-2027	Materialet informuese, platforma digjitale	1,000 EUR x3 =3,000 EUR

	6.5 Promovimi i modeleve pozitive të bashkëmosh atarëve që vijnë nga radhët e komunitetev e jo-shumicë	Organizimi i sesioneve dhe fushatave që prezantojnë role pozitive nga personat që vijnë nga radhët e komuniteteve jo shumicë në fusha të ndryshme si sporti, arti, shkenca, dhe biznesi me qëllim frymëzimin e të rinjve	Numri i sesioneve, pjesëmarrja e të rinjve, ndikimi në aspiratat e tyre.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Shkollat, mediat, organizatat që punojnë për fuqizimin e komunitetev e jo-shumicë	2024-2027	Materialet promovue se, hapësirat për ngjarje	1,000 EUR x3 =3,000 EUR
	6.6 Promovimi i diversitetit kulturor	Organizimi i fushatave dhe aktiviteteve që	Numri i aktiviteteve të realizuara,	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Shkollat, mediat, OJQ- të	2024-2027	Materialet promovue se,	1,000 EUR x3 =3,000 EUR

		promovojnë diversitetin kulturor, përfshirë festivale, ekspozita dhe sesione informuese.	pjesëmarrja e komunitetit mazhoritar, ndikimi në perceptime.				hapësirat për ngjarje	
	6.7 Integrimi i fëmijëve në situatë rruge	Hapja e qendrave të reja që ofrojnë mbështetje dhe shërbime për fëmijët në situatë rrugë, duke përfshirë arsimin, ushqimin dhe kujdesin shëndetësor.	Numri i qendrave të hapura, numri i fëmijëve të përfshirë, përmirësimi i kushteve të tyre të jetesës.	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	OJQ-të, donatorët	2024-2027	Hapësirat për qendrat, stafi	1,000 EUR x3 =3,000 EUR



SHTOJCA 2

Integrimi i Agjendave “Rinia, Paqja dhe Siguria (YPS)” dhe “Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS)” në Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt

Kjo shtojcë synon të përforcojë zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt përmes integritit të parimeve të agjendave ndërkombëtare Rinia, Paqja dhe Siguria (Youth, Peace and Security – YPS) dhe Gratë, Paqja dhe Siguria (Women, Peace and Security – WPS). Këto agjenda të Kombeve të Bashkuara theksojnë rëndësinë e përfshirjes aktive të të rinjve dhe grave në vendimmarrje, ndërtimin e paqes dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.

Integrimi i këtyre parimeve në nivel lokal kontribuon në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës për të rinjtë dhe të rejtat. Ai gjithashtu ndihmon institucionet komunale të harmonizojnë politikat dhe programet e tyre me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira në fushën e fuqizimit të rinisë dhe barazisë gjinore.

Agjenda Rinia, Paqja dhe Siguria (YPS) u themelua përmes Rezolutës 2250 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe thekson rolin e rëndësishëm të të rinjve në parandalimin e konflikteve dhe promovimin e paqes. Ajo bazohet në pesë shtylla kryesore: pjesëmarrja, mbrojtja, parandalimi, partneriteti dhe riintegrimi. Këto parime synojnë të sigurojnë që të rinjtë të kenë mundësi reale për të kontribuar në zhvillimin e komuniteteve të tyre dhe të jenë pjesë aktive e proceseve vendimmarrëse.

Në mënyrë të ngjashme, agjenda Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS) promovon fuqizimin e grave dhe vajzave dhe garantimin e pjesëmarrjes së tyre në proceset e paqes dhe qeverisjes. Kjo agjendë përqendrohet në mbrojtjen nga dhuna, promovimin e barazisë gjinore dhe përfshirjen e grave në proceset e zhvillimit dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet.

Integrimi i këtyre agjendave në strategjinë komunale për rininë përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të politikave lokale dhe rritjes së ndikimit të tyre në komunitet. Në këtë kuadër rekomandohet forcimi i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse përmes konsultimeve të rregullta, përfshirjes në mekanizmat rinorë dhe bashkëpunimit me organizatat rinore dhe Këshillin Rinor Lokal.

Gjithashtu është e rëndësishme të promovohet barazia gjinore në të gjitha strukturat dhe aktivitetet rinore. Kjo nënkupton përfaqësim të balancuar gjinor në grupet punuese dhe programet rinore, si dhe zhvillimin e iniciativave që fuqizojnë vajzat dhe gratë e reja përmes programeve të mentorimit, trajnimeve për leadership dhe zhvillimit të aftësive personale dhe profesionale.

Një element tjetër i rëndësishëm është përforsimi i masave për sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve. Institucionet lokale duhet të bashkëpunojnë me shkollat, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e sigurisë për të parandaluar dhunën, bullizmin dhe diskriminimin në shkolla dhe hapësira publike. Në të njëjtën kohë duhet të promovohen programe të ndërgjegjësimi për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike të të rinjve.

Përveç kësaj, strategjia duhet të përfshijë aktivitete që nxisin dialogun ndërkulturor dhe bashkëpunimin mes të rinjve nga komunitete të ndryshme. Aktivitetet ndërshkollore, kampet rinore dhe trajnimet për zgjidhjen e konflikteve janë mjete efektive për ndërtimin e besimit dhe promovimin e kulturës së paqes në komunitet.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre masave, është e nevojshme të vendosen mekanizma të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Institucionet komunale duhet të përcaktojnë indikatorë të matshëm për çdo aktivitet dhe të raportojnë rregullisht për progresin e arritur. Përfshirja e të rinjve në procesin e monitorimit rrit transparencën dhe siguron që politikat publike të reflektojnë realisht nevojat dhe prioritetet e tyre.

Gjithashtu rekomandohet që komuna të forcojë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, institucionet arsimore, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë. Partneritetet ndërsektoriale mundësojnë mobilizimin e burimeve shtesë dhe rritjen e efektivitetit të programeve për rininë.

Në përfundim, integrimi i agjendave YPS dhe WPS në Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt paraqet një mundësi të rëndësishme për të forcuar rolin e të rinjve dhe grave në zhvillimin e komunitetit. Përmes përfshirjes aktive, promovimit të barazisë gjinore dhe krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit dhe monitorimit, komuna mund të ndërtojë politika më gjithëpërfshirëse dhe më efektive për rininë.

Zbatimi i këtyre parimeve do të kontribuojë në krijimin e një komuniteti më të sigurt, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm, ku të rinjtë dhe të rejtat kanë mundësi të barabarta për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të qytetit.

Konkluzione:

Integrimi i agjendave Rinia, Paqja dhe Siguria (YPS) dhe Grtë, Paqja dhe Siguria (WPS) në “Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029” dhe “Planin Komunal të Veprimit për Rininë 2024-2027”, përfaqëson një hap vendimtar drejt fuqizimit të pjesëmarrjes së të rinjve dhe grave në vendimmarrje, promovimit të barazisë gjinore, dhe sigurimit të një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për grupet më të cënueshme. Rekomandimet e propozuara synojnë të forcojnë strukturat ekzistuese, të krijojnë mekanizma të qartë monitorimi dhe përgjegjësie, si dhe të sigurojnë zbatimin praktik dhe të matshëm të objektivave strategjike.

Zbatimi i këtyre masave do të mundësojë:

1. Pjesëmarrje kuptimplotë dhe të barabartë të të rinjve dhe grave në proceset vendimmarrëse;
2. Reduktimin e rreziqeve për dhunë, diskriminim dhe radikalizim;
3. Përf forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rrjeteve bashkëpunuese në nivel lokal dhe rajonal;

4. Sigurimin e qasjeve të integruara për shëndetin mendor, arsimimin, punësimin dhe reintegrimin social të të rinjve dhe grave në rrezik.

Këto rekomandime krijojnë një mundësi unike që Komuna e Ferizajt të bëhet shembull i harmonizimit të politikave lokale me standardet ndërkombëtare të OKB-së, duke ndërtuar një komunitet më të fortë, më të qëndrueshëm dhe më gjithëpërfshirës, si dhe duke forcuar rolin dhe pjesëmarrjen e rinjve dhe të rejave në komunitet si dhe në proceset e vendimmarrjes lokale.

AKTIVITETET	Përshkrimi i aktiviteteve	INDIKATORËT	INSTITUCION I/ET PËRGJEGJËS/ E	ORGANET E TJERA MBËSHTETËSE	PERIUDHA IMPLEMENTUESE	MJETET/PAJISJET	BUXHETI
Kapitull i veçantë për YPS/WPS	Futja e një kapitulli në strategji që shpjegon orientimin ndaj agjendave YPS dhe WPS	Kapitulli i përfshirë në strategji; dokument i harmonizuar me standardet ndërkombëtare	DKRS, Komuna e Ferizajt	OJQ, organizata ndërkombëtare	2024–2025	Dokumente strategjike, ekspertizë	

Objektiva të matshëm për pjesëmarrjen e të rinjve	Përditësimi i strategjisë me indikatorë për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje	% e të rinjve në komisione; numri i konsultimeve publike	DKRS, Kuvendi Komunal	Këshilli Rinor Lokal, OJQ	2024–2027	Salla takimesh, platforma konsultimi	
Kuota gjinore në mekanizmat rinorë	Vendosja e përfaqësimit minimal 50% të vajzave dhe grave të reja në mekanizmat rinorë	% e përfaqësimit gjinor në trupat rinorë	DKRS	Këshilli Rinor Lokal, OJQ	2024–2027	Udhëzime administrative	
Gjuhë e ndjeshme gjinore	Zbatimi i gjuhës gjithëpërfshirëse në dokumente dhe aktivitete	Dokumente të hartuara me gjuhë gjithëpërfshirëse	Zyra për Barazi Gjinore, DKRS	OJQ, institucione arsimore	2024–2027	Manuale, trajnime	

Siguria e të rinjve	Masat për sigurinë në shkolla dhe hapësira publike	Numri i aktiviteteve parandaluese; protokolle të zbatuara	DKA, Policia e Kosovës	Shkollat, OJQ	2024–2027	Materiale ndërgjegjësimi	
Shëndeti mendor	Promovimi i shërbimeve dhe ndërgjegjësimi për shëndetin mendor	Psikologë në shkolla; aktivitete ndërgjegjësimi	DKA, DSHMS	Qendra shëndetësore, OJQ	2024–2027	Qendra këshillimi, materiale edukative	
Parandalimi i radikalizimit	Programe edukimi mediatik dhe identifikim i hershëm i rrezikut	Numri i trajnimeve dhe aktiviteteve	Komuna, Policia	OJQ, ekspertë sigurie	2024–2027	Trajnime, materiale	

Mbështetje për grupet e ndjeshme	Masa për përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë dhe të rinjve me aftësi të kufizuara	Numri i pjesëmarrësve nga grupet e synuara	DKRS	OJQ, qendra sociale	2024–2027	Programe sociale	
Dialog ndëretnik	Aktivitete ndërkulturore dhe trajnime për zgjidhjen e konflikteve	Numri i aktiviteteve ndërkulturore	DKA, DKRS	OJQ, shkolla	2024–2027	Kampe rinore, trajnime	
Partneritete ndërsektorale	Krijimi i bashkëpunimeve me OJQ, sektor privat dhe komuna tjera	Marrëveshje bashkëpunimi	Komuna	Partnerë ndërkombëtarë	2024–2027	Takime koordinuese	

Monitorim nga të rinjtë	Krijimi i grupit monitorues rinor për strategjinë	Raporte monitorimi çdo 6 muaj	DKRS	Këshilli Rinor Lokal	2024–2027	Platforma raportimi	
Lidership për vajzat	Programe mentorimi dhe shkolla lidershpi	Numri i vajzave pjesëmarrëse	DKRS	OJQ, institucione arsimore	2024–2027	Trajnime	
Fushata ndërgjegjësimi	Fushata për barazi gjinore, shëndet mendor dhe kundër gjuhës së urrejtjes	Numri i fushatave dhe pjesëmarrësve	Komuna	OJQ, media	2024–2027	Materiale promovuese	
Indikatorë të matshëm	Përcaktimi i indikatorëve për secilin objektiv të strategjisë	Tabela e indikatorëve e përfshirë në strategji	DKRS	Partnerë zhvillimorë	2024–2025	Dokumente analitike	

Transparencë financiare	Specifikimi i linjave buxhetore për aktivitete rinore	Buxhet i publikuar për aktivitete	Komuna	Kuvendi Komunal	2024–2027	Raporte financiare	
Reintegrim social	Programe për të rinj në rrezik social	Numri i përfituesve të programeve	DSHMS	OJQ, shkolla	2024–2027	Shërbime sociale	
Plan implementimi	Tabela me afate, përgjegjësi dhe indikatore	Plani i implementimit i miratuar	Komuna	Partnerë	2024	Dokument strategjik	
Trajnim i stafit institucional	Trajnime për YPS dhe WPS për stafin komunal	Numri i stafit të trajnuar	DKRS	Organizata ndërkombëtare	2024–2026	Salla trajnimi	
Analizë gjinore në projekte	Kërkesë për analizë gjinore në projektet e financuara	Projekte me analizë gjinore	Komuna	OJQ	2024–2027	Udhëzime, formularë	

Qasje në shërbime për viktimat e dhunës	Pika referimi dhe bashkëpunim me shërbime psikosociale	Numri i rasteve të referuara	DSHMS	Qendra shëndetësore, OJQ	2024–2027	Qendra mbështetje	
Përfshirja e organizatave rinore	Pjesëmarrja e OJQ-ve rinore në zbatim dhe monitorim	Numri i aktiviteteve të përbashkëta	DKRS	OJQ rinore	2024–2027	Takime koordinimi	
Komunikim publik për strategjinë	Fushatë informuese për publikun mbi strategjinë	Numri i aktiviteteve informuese	Komuna	Media, OJQ	2024–2025	Materiale informuese	